# FLETORJA ZYRTARE

# E

# REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare**

| **Nr.26** | **2005** | **28 prill** |
|---|---|---|

## P Ë R M B A J T J A

| | | Faqe |
|---|---|---|
| Ligj nr.9356<br>datë 17.3.2005 | Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.8685, datë 9.11.2000 "Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në miniera, në nëntokë"........................................................... | 985 |
| Ligj nr.9357<br>datë 17.3.2005 | Për statusin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit ......... | 986 |
| Ligj nr.9358<br>datë 24.3.2005 | Për ratifikimin e “Marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane, për programin vjetor kombëtar të veprimit, CARDS 2004”...................................................... | 999 |
| Ligj nr.9366<br>datë 31.3.2005 | Për gradat dhe karrierën në Gardën e Republikës së Shqipërisë.. | 1023 |

**LIGJ**
**Nr. 9356, datë 17.3.2005**

## PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8685, DATË 9.11.2000 "PËR NJË TRAJTIM TË VEÇANTË TË PUNONJËSVE, QË KANË PUNUAR NË MINIERA, NË NËNTOKË"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8685, datë 9.11.2000 "Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në miniera, në nëntokë", bëhen këto shtesa e ndryshime:

Neni 1

Në nenin 5 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:
"Të gjithë personat, që përfitojnë trajtim të veçantë, sipas këtij ligji, kanë të drejtë ta marrin atë deri në çastin që plotësojnë kushtet për një lloj përfitimi nga ligji nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" ose deri kur ata bëhen ekonomikisht aktivë, me përjashtim të personave, të cilët ushtrojnë veprimtari ekonomike si të vetëpunësuar në bujqësi e blegtori.".

Neni 2

Pas nenit 6 shtohen nenet 6/1 dhe 6/2 me këtë përmbajtje:

"Neni 6/ 1

Përfitimet nga ky ligj nuk tatohen.
Përfitimet e caktuara, sipas këtij ligji, rriten ose indeksohen sa herë dhe në atë masë që rriten ose indeksohen pensionet e pleqërisë nga sigurimi i detyrueshëm shoqëror.
Përfitimet e caktuara, por të patërhequra, paguhen në çdo kohë, por jo më shumë se për 1 vit.
Përfitimet e caktuara, por të paguara më pak, jepen në çdo kohë, por jo më shumë se për 1 vit.
E drejta për të kërkuar shumat e marra tepër gjatë një viti ushtrohet jo më vonë se 3 vjet nga marrja e tyre, por jo më vonë se 6 muaj nga data e konstatimit. Masa e ndalesës për çdo muaj është 20 për qind e këstit mujor të trajtimit të veçantë.
Personi, që ka përfituar të ardhura, në mënyrë e me mjete të padrejta, si dhe që nuk njofton ndryshimin ose heqjen e masës së tyre, detyrohet të kthejë të gjithë shumën e marrë tepër. Masa e ndalesës për çdo muaj është 50 për qind e këstit mujor të trajtimit të veçantë.

Neni 6/2

Periudha e përfitimit të trajtimit të veçantë, duke filluar nga data 16.12.2000 e në vazhdim, njihet periudhë sigurimi, për efekt pensioni pleqërie, invaliditeti e familjar, nga skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror.

Në këtë rast kontributet përballohen nga Buxheti i Shtetit, në nivelin minimal, në kohën kur merret vendim për caktimin e pensionit.".

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4530, datë 13.4.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu**

**LIGJ**
**Nr. 9357, datë 17.3.2005**

**PËR STATUSIN E PUNONJËSIT TË SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHTETIT**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
**Objekti dhe qëllimi**

Ky ligj përcakton statusin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit, pozitën juridike, administrative, kriteret e pranimit dhe të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, detyrimet e të drejtat e punonjësit të këtij Shërbimi dhe garancitë ligjore për realizimin e tyre.

Neni 2
**Përkufizime**

Për qëllim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. "Kursant" është shtetasi, që përgatitet në kurset e institutit të këtij Shërbimi, për t'u bërë punonjës aktiv i Shërbimit Informativ të Shtetit.
2. "Punonjës në detyrë" është shtetasi në marrëdhënie pune në Shërbimin Informativ të Shtetit.
3. "Punonjës në pension" është shtetasi, që ka punuar në strukturat e Shërbimit Informativ të Shtetit dhe del në pension të parakohshëm ose në pension të plotë pleqërie.
4. "Punonjës në lirim" është shtetasi, që ndërpret marrëdhëniet e punës me Shërbimin Informativ të Shtetit.
5. "Punonjës i përjashtuar" është shtetasi, të cilit i ndërpriten marrëdhëniet e punës me Shërbimin Informativ të Shtetit.

Neni 3
**Marrja dhe humbja e të drejtës së statusit**

1. Këtë status e fitojnë dhe e gëzojnë punonjësit në detyrë, punonjësit në pension, punonjësit në lirim dhe kursantët, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj dhe në akte të tjera ligjore e nënligjore.

2. Punonjësi i Shërbimit Informativ të Shtetit e humbet statusin kur dënohet me vendim të formës së prerë nga gjykata me burgim, për krime të kryera me dashje.

Neni 4
**Vjetërsia në punë**

Si vjetërsi në punë e punonjësit të këtij Shërbimi për efekt pensioni njihet:

a) koha nga data e pranimit si kursant në SHISH;

b) koha e studimit në shkollat e larta ushtarake, të policisë dhe në shkollat me natyrë të ngjashme me to;

c) koha kur është njohur si punonjës i SHISH-it;

ç) koha kur është njohur si ushtarak i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë ose si punonjës i policisë;

d) koha e ndërprerjes së karrierës në shërbim, për shkak të një vendimi të padrejtë, të cilësuar si i tillë nga gjykata;

dh) koha e trajtimit me pagesë kalimtare;

e) koha e njohur si pension i parakohshëm për vjetërsi shërbimi;

ë) koha si punonjës në sektorët joushtarakë, para pranimit si punonjës i SHISH-it;

f) koha e njohur si punonjës i Shërbimit Informativ Ushtarak.

KREU II
PRANIMI, KLASIFIKIMI, VLERËSIMI, NGRITJA NË DETYRË,
TRANSFERIMI DHE KOMANDIMI

Neni 5
**Kërkesat për t'u pranuar në SHISH**

1. Për t'u pranuar në Shërbimin Informativ të Shtetit, personi duhet të plotësojë këto kërkesa:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

c) të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të jetë i aftë nga ana shëndetësore;

ç) të mos jetë dënuar me vendim gjykate të formës së prerë, për kryerjen e një krimi.

2. Personat, që punësohen në Shërbimin Informativ të Shtetit, krahas kërkesave të përgjithshme, duhet të plotësojnë kushtin e sigurisë dhe disa kërkesa të veçanta, për punë të veçantë. Verifikimi i kushtit të sigurisë zbatohet ndaj personit, i cili kërkon të punësohet në SHISH, si dhe për lidhjet e tij me personat e familjes ose jashtë saj.

3. Personat që nuk plotësojnë kushtin e sigurisë, nuk mund të lidhin marrëdhënie pune me SHISH-in.

4. Pranimi në SHISH bëhet me konkurrim të hapur, por në raste të veçanta edhe pa konkurrim. Shpallja e vendit të lirë të punës botohet në dy gazeta kombëtare me tirazh të madh të pakën 30 ditë para datës së konkursit. Pranimi kalon në fazat e shqyrimit dhe të verifikimit paraprak të dokumentacionit, të testimit me shkrim dhe të intervistës me gojë.

5. Në raste të veçanta dhe për profesione specifike pranimi në Shërbim mund të kryhet me urdhër të Drejtorit pa konkurrim.

6. Shërbimi Informativ i Shtetit nuk është i detyruar ta sqarojë shtetasin për shkaqet, për të cilat ai nuk është pranuar në punë.

7. Kriteret e veçanta për pranimin në punë, përbërja e komisionit të testimit, procedura e zhvillimit të konkursit dhe rastet e zhvillimit të procedurave të pranimit pa konkurrim përcaktohen në rregulloren e brendshme, të miratuar nga Drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit.

Neni 6
**Ndërprerja e kursit**

1. Shtetasi, i cili pranohet në SHISH për t'u trajnuar në kurs, ndërpret marrëdhëniet me këtë Shërbim, nëse gjatë kursit vlerësohet se nuk ka aftësitë e nevojshme për kryerjen e detyrave në këtë Shërbim.

2. Marrëdhëniet ndërpriten me urdhër të Drejtorit të SHISH-it, pas propozimit të drejtorit të institutit, të konfirmuar edhe nga njësia e ngarkuar me funksionet e inspektimit.

Neni 7
**Periudha e provës**

1. Punonjësi, që punësohet në Shërbimin Informativ të Shtetit, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, i nënshtrohet një periudhe prove prej 1 viti nga data e emërimit. Gjatë kësaj periudhe ai është nën kujdesin e një punonjësi me stazh në punë dhe vlerësohet nga eprori më i afërt i tij. Kërkesat për kryerjen e detyrës gjatë periudhës së provës përcaktohen me udhëzim të Drejtorit të SHISH-it.

2. Në fund të periudhës së provës, me propozimin e eprorit direkt, Drejtori vendos:

a) konfirmimin si punonjës i SHISH-it, kur vlerësohet i aftë për të marrë përsipër realizimin e detyrës;

b) zgjatjen e periudhës së provës edhe për një vit, kur vlerësohet se nuk ka arritur plotësisht aftësitë për të punuar i pavarur;

c) lirimin nga Shërbimi Informativ i Shtetit, kur vlerësohet i paaftë për të marrë përsipër e për të realizuar detyrën në SHISH. Paaftësia duhet të konfirmohet nga njësia e ngarkuar me funksionet e inspektimit.

Neni 8
**Klasifikimi i punonjësve**

Klasifikimi i punonjësve të SHISH-it bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 9
**Vlerësimi i punës**

1. Vlerësimi i punës së punonjësit të SHISH-it bëhet një herë në vit, si dhe në rastet e mbarimit të periudhës së provës, transferimit, komandimit dhe përjashtimit nga ky Shërbim.

2. Vlerësimi bëhet në bazë të realizimit të objektivave të përcaktuar të cilësisë dhe shpejtësisë në kryerjen e detyrës dhe të disiplinës në punë.

3. Shkallët e vlerësimit janë:

a) shumë mirë;

b) mirë;

c) mjaftueshëm;

ç) jo mjaftueshëm.

4. Drejtori i SHISH-it, me udhëzim të veçantë, përcakton procedurat dhe kriteret e vlerësimit të punës.

Neni 10
**Ngritja në detyrë**

1. Punonjësi i Shërbimit Informativ të Shtetit mund të ngrihet në detyrë kur vlerësohet me shkallën "shumë mirë".

2. Punonjësi, që ka masë disiplinore të pashlyer, nuk mund të ngrihet në detyrë.

Neni 11
**Transferimi**

1. Transferimi i punonjësit mund të bëhet nga Drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit, vetëm për nevoja dhe në interes të punës.
2. Transferimi, si rregull, bëhet me pëlqimin e punonjësit.
3. Punonjësi, që transferohet jashtë vendbanimit të përhershëm, e merr me vete edhe familjen dhe gëzon:
a) të drejtën e paradhënies dhe të rimbursimit të plotë të shpenzimeve të transferimit të tij dhe të familjes;
b) ndihmë të menjëhershme në të holla, deri në 4 paga mujore të vendit të punës që ka pasur në çastin e transferimit.
4. Punonjësi, që nuk pranon të transferohet mund të ankohet te Drejtori i Shërbimit , i cili, brenda 30 ditëve, shqyrton ankesën dhe shprehet përfundimisht.
5. Punonjësi, që transferohet me kërkesën e vet, nuk gëzon të drejtat e shkronjave “a” e “b” të pikës 3 të këtij neni.

Neni 12
**Komandimi**

1. Punonjësi i SHISH-it mund të komandohet me urdhër të Drejtorit të këtij Shërbimi:
a) për jo më shumë se dy periudha 3-mujore në vit, për mbarëvajtjen e punës ose në raste të mbingarkesës së krijuar në një njësi strukturore;
b) jo më shumë se koha e nevojshme për përfundimin e procesit të një çështjeje të veçantë, por jo më shumë se 6 muaj.
2. Gjatë kohës së komandimit, punonjësit i ruhet vendi i punës, ku merr edhe pagën.
3. Në rastet kur fjetja, transporti dhe ushqimi nuk i sigurohen nga Shërbimi Informativ i Shtetit, punonjësi i komanduar përfiton dieta, sipas legjislacionit në fuqi.

KREU III
DETYRAT, PËRGJEGJËSITË DHE TË DREJTAT
E PUNONJËSIT

Neni 13
**Detyrat kryesore**

1. Punonjësi i Shërbimit Informativ të Shtetit ka këto detyra kryesore:
a) të njohë, të respektojë, të zbatojë dhe të veprojë në përputhje me Kushtetutën dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi;
b) të ushtrojë me përkushtim detyrën dhe të veprojë me profesionalizëm e me përgjegjësi;
c) të jetë i paanshëm, objektiv dhe i drejtë. Të mos niset nga interesi i përfitimit personal e të mos krijojë favore për individë të caktuar, duke u kushtëzuar nga motive, që nuk lidhen me realizimin me ndërgjegje të detyrës;
ç) të realizojë me besnikëri detyrat e funksionet zyrtare, pavarësisht nga pikëpamja personale dhe të zbatojë me përpikëri urdhrat ose vendimet e organeve eprore;
d) të mbajë përgjegjësi të plotë për veprimet e mosveprimet e veta, gjatë ushtrimit të detyrës dhe, kur nuk është i bindur për ligjshmërinë e urdhrave e të vendimeve, të vërë në dijeni menjëherë urdhërdhënësin dhe eprorët e këtij të fundit;
dh) të zbatojë rregullat e etikës së administratës publike;
e) të rrisë aftësitë profesionale dhe të marrë pjesë në veprimtari trajnuese.

2. Punonjësi i SHISH-it është i detyruar të kryejë detyrat, për të cilat është ngarkuar edhe kur ato i rrezikojnë jetën, shëndetin dhe pasurinë.

Neni 14
**Përgjegjësia e punonjësit**

Për shkeljen e akteve ligjore e nënligjore të disiplinës në punë dhe për dëme materiale të pronës publike ose private, punonjësi i Shërbimit Informativ të Shtetit mban përgjegjësi penale, administrative, materiale apo civile, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 15
**Ruajtja e dinjitetit**

1. Punonjësi i SHISH-it është i detyruar të ruajë dinjitetin e institucionit.
2. Paraqitja në publik, komunikimi dhe veprimet e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit përfaqësojnë autoritetin e institucionit.

Neni 16
**Depolitizimi**

1. Punonjësi i Shërbimit Informativ të Shtetit përpara fillimit të detyrës deklaron me shkrim mospjesëmarrjen në parti politike.
2. Punonjësi i SHISH-it nuk duhet të manifestojë sjellje dhe të mbajë qëndrime, që cenojnë natyrën e depolitizuar të institucionit.
3. Punonjësit të SHISH-it i ndalohet anëtarësimi dhe pjesëmarrja në veprimtaritë e partive apo të shoqatave politike, si dhe të bëjë propagandë në favor ose kundër partive, shoqatave politike, ose kundër kandidatëve në zgjedhje.

Neni 17
**Kufizimi i të drejtës së grevës**

Punonjësi i Shërbimit Informativ të Shtetit nuk ka të drejtë të bëjë grevë, si dhe të bëjë kërkesa e ankesa kolektive.

Neni 18
**Dypunësimi**

Punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit i ndalohet të punësohet pranë personave fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, pa miratimin e Drejtorit të SHISH-it.

Neni 19
**Ruajtja e pronës**

1. Punonjësi i Shërbimit Informativ të Shtetit është i detyruar të ruajë e të mirëmbajë mjediset e punës, mjetet e dhëna në përdorim për kryerjen e detyrës, teknikën dhe armatimin.
2. Punonjësi i Shërbimit Informativ të Shtetit përgjigjet për dëmin që i shkakton, me dashje apo nga pakujdesia, pasurisë së këtij Shërbimi.

Në këtë rast, brenda 6 muajve nga data e zbulimit të dëmit, por jo më vonë se 3 vjet nga data e shkarkimit, nxirret urdhri i zhdëmtimit. Ky urdhër është titull ekzekutiv.

Kundër urdhrit të zhdëmtimit, punonjësi ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës.

Neni 20

**Dëmi i shkaktuar ndaj të tretëve**

1. Për dëmin e shkaktuar nga punonjësi i SHISH-it, në detyrë dhe për shkak të detyrës, ndaj qytetarëve ose personave fizikë e juridikë, është përgjegjës Shërbimi Informativ i Shtetit.

2. Shërbimi Informativ i Shtetit, sipas rrethanave, kërkon nga punonjësi fajtor shpenzimet e zhdëmtimit për dëmin e shkaktuar.

3. Punonjësi i SHISH-it, përgjegjës për dëmin e shkaktuar, sipas pikës 1 të këtij neni, për shkaqe të arsyetuara, sipas të cilave dëmi nuk mund të shmangej, mund të përjashtohet, tërësisht ose pjesërisht, nga shpenzimet e zhdëmtimit.

4. Drejtori i SHISH-it vlerëson rrethanat, sipas pikës 2 të këtij neni dhe merr vendim për përjashtimin tërësisht ose pjesërisht nga dëmi.

5. Kur punonjësi detyrohet të paguajë shpenzimet e zhdëmtimit, sipas pikës 2 të këtij neni, kundër urdhrit të zhdëmtimit, ai ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës.

Neni 21

**Kufizimi i lirisë së lëvizjes**

1. Punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit i kufizohet e drejta e lëvizjes jashtë juridiksionit ku punon. Për lëvizje jashtë këtij juridiksioni, edhe në kohën e lirë, ai njofton eprorin përkatës.

2. Punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit i lejohet dalja jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë me miratimin e Drejtorit të këtij Shërbimi ose të të autorizuarit prej tij.

Neni 22

**E drejta e pagës**

1. Paga mujore e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit përbëhet nga paga bazë për funksionin organik, shtesa për gradë dhe shtesat me karakter të përhershëm.

Për shkak të natyrës së veçantë të punës dhe kufizimeve të përcaktuara me ligj, punonjësi i Shërbimit Informativ të Shtetit ka përparësi në trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë.

2. Punonjësi i Shërbimit Informativ të Shtetit përfiton edhe shtesa e trajtime të veçanta për rastet dhe funksionet analoge, në sektorët e njëjtë buxhetorë. Të drejtën e pagës e gëzojnë edhe kursantët, për periudhën e kursit.

3. Rregullimi i pagave dhe i trajtimeve të tjera ekonomike e financiare bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 23

**Pagesa për aktivizimin e punonjësve në trajtim me pagesë kalimtare, në pension të parakohshëm ose në pension të plotë pleqërie**

1. Drejtori i SHISH-it, për nevoja të këtij Shërbimi ose për zgjidhjen e problemeve nga specialistë me kualifikim të veçantë, mund të aktivizojë punonjës të SHISH-it, të cilët janë në trajtim me pagesë kalimtare, në pension të parakohshëm ose në pension të plotë pleqërie.

2. Punonjësi, që aktivizohet, sipas pikës 1 të këtij neni, përfiton pagë mujore të njëjtë me atë të punonjësit në detyrë, të të njëjtit funksion, si dhe u nënshtrohet të gjitha detyrimeve, si punonjësit në detyrë.

3. Punonjësit të aktivizuar, në datën e aktivizimit, i ndërpritet pagesa kalimtare, pensioni i parakohshëm ose pensioni i plotë i pleqërisë.

4. Pagesa e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni përfundon në datën që punonjësi i aktivizuar ndërpret aktivizimin dhe ai rimerr pagesën kalimtare, pensionin e parakohshëm ose pensionin e plotë të pleqërisë.

5. Drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit, Ministri i Financave dhe Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale nxjerrin udhëzim të përbashkët në zbatim të këtij neni.

Neni 24
**E drejta e pensionit të parakohshëm për vjetërsi pune**

1. Punonjësi i SHISH-it, me vjetërsi shërbimi 15 vjet për burrat dhe 12 vjet për gratë, gëzon të drejtën e pensionit të parakohshëm në masën 50 për qind të pagës mujore, deri në plotësimin e kushteve për përfitimin e pensionit të plotë të pleqërisë.
2. Për çdo vit tjetër pune në shërbim mbi kufirin e mësipërm, punonjësit i jepet një shtesë pensioni në masën 2 për qind të pagës mujore.
3. Pensioni i parakohshëm për vjetërsi pune në shërbim nuk ndërpritet në rastin e punësimit të përfituesit jashtë strukturave të SHISH-it.
4. Kriteret dhe kushtet e përfitimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi pune në shërbim përcaktohen në ligjin nr.8087, datë 13.3.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ të Shtetit", të ndryshuar.

Neni 25
**Sigurimet shoqërore suplementare**

Punonjësi i Shërbimit Informativ të Shtetit në detyrë, në lirim ose në pension, pavarësisht nga koha e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me këtë shërbim, përveç përfitimeve të përcaktuara në këtë ligj, përfiton sigurime shoqërore suplementare për vete dhe familjen, sipas ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ të Shtetit", të ndryshuar.

Neni 26
**Koha e punës**

1. Koha e punës për punonjësin e Shërbimit Informativ të Shtetit njësohet me atë të punonjësve të tjerë të administratës publike. Administrimi i saj rregullohet nga Drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit.
2. Për nevoja të punës dhe interesa të këtij Shërbimi, koha e punës mund të zgjatet tej kohës normale. Pagesa për punonjësin e Shërbimit Informativ të Shtetit, për punë jashtë kohës normale të punës, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 27
**Koha e pushimit**

1. Punonjësi i SHISH-it gëzon të drejtën e pushimit javor, të pushimit vjetor të paguar dhe të pushimeve të tjera të përcaktuara në këtë ligj dhe në akte të tjera ligjore dhe nënligjore.
Pushimi vjetor për punonjësin e Shërbimit Informativ të Shtetit jepet i shkallëzuar. Kohëzgjatja e pushimit vjetor të paguar është 40 ditë kalendarike për inspektorët e drejtuesit dhe 30 ditë kalendarike për ndihmësinspektorët.
2. Kur pushimi vjetor, për arsye pune ose shërbimi, nuk jepet brenda vitit, ai duhet të jepet jo më vonë se në muajin mars të vitit pasardhës, në të kundërt, bëhet kompensim në vlerë.
3. Kur punonjësi, gjatë kryerjes së lejes së pagueshme vjetore, për arsye shëndetësore bëhet i paaftë për punë dhe këtë e vërteton me raport mjekësor, ai njofton qendrën e punës dhe pushimi vjetor i zgjatet për atë periudhë kohe.

4. Në rast të martesës së tij ose të pjesëtarëve të familjes apo në rast fatkeqësie familjare ose sëmundjeje të rëndë të pjesëtarëve të familjes apo në raste të tjera të ngjashme me to, punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit, me urdhër të Drejtorit të SHISH-it, i jepen deri në 10 ditë leje e pagueshme ose deri në 2 muaj leje pa të drejtë page.

Neni 28
**E drejta e pushimit në filialet e trajnimit dhe të kualifikimit**

1. Punonjësi i Shërbimit Informativ të Shtetit ka të drejtë të pushojë në filialet e trajnimit dhe të kualifikimit të institutit, të përshtatura për pushim, në përdorim e administrim të SHISH-it.
2. Të drejtën për të pushuar në këto filiale e ka edhe punonjësi në lirim.
3. Rregullat e kriteret për të pushuar dhe masa e pagesës përcaktohen nga Drejtori i SHISH-it.

Neni 29
**Shpërblimet**

1. Punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit i jepen shpërblime në vlera monetare, kur ai ka rezultate shumë të mira në punë, në ruajtjen dhe administrimin e pronës, si dhe kur kryen detyra me rreziqe e mundime të veçanta për jetën ose shëndetin.
2. Kriteret dhe masa e shpërblimeve caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 30
**Të drejta të tjera**

Punonjësi i SHISH-it ka edhe këto të drejta:
a) të përparojë në karrierë;
b) të mbrohet nga shteti në kryerjen e detyrave të ngarkuara;
c) të trajnohet, të kualilikohet dhe të ndjekë studimet, brenda e jashtë vendit, me leje të Drejtorit.

Neni 31
**Armatimi**

1. Punonjësi në detyrë në njësi të veçanta të Shërbimit Informativ të Shtetit, të përcaktuara nga Drejtori i këtij Shërbimi, është i pajisur me armatim për kryerjen e detyrave, por këtë armatim duhet ta përdorë në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Kur punonjësi në detyrë, për shkaqe të ndryshme, ndërpret marrëdhëniet e punës, dorëzon armatimin vetjak.
3. Kur punonjësi në detyrë i SHISH-it vdes, familjarët dorëzojnë armatimin e tij në qendrën e punës brenda 30 ditëve.

Neni 32
**Dokumenti i identifikimit**

1. Punonjësi i Shërbimit Informativ të Shtetit pajiset me dokument zyrtar identifikimi, sipas kritereve të përcaktuara nga Drejtori i këtij Shërbimi.
2. Punonjësi i Shërbimit Informativ të Shtetit nuk e paraqet në publik dokumentin e identifikimit, përveçse në rastet kur i duhet për përmbushjen e detyrës.
3. Kur punonjësi në detyrë, për shkaqe të ndryshme, ndërpret marrëdhëniet e punës, dorëzon dokumentin e identifikimit.
4. Kur punonjësi në detyrë i SHISH-it vdes, familjarët dorëzojnë dokumentin e identifikimit të tij në qendrën e punës brenda 30 ditëve.

Neni 33
**Uniforma**

Njësi të veçanta të Shërbimit Informativ të Shtetit pajisen me uniformë, të cilën e përdorin vetëm gjatë ushtrimit të detyrës. Uniforma dhe shenjat dalluese përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 34
**Trajtimi me ushqim e veshmbathje**

1. Punonjësi i Shërbimit Informativ të Shtetit trajtohet me ushqim në vlerë, sipas normave të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.
2. Punonjësi i Shërbimit Informativ të Shtetit trajtohet me veshmbathje në vlerë, një herë në vit, në masën e një page mujore të vendit të punës.

Neni 35
**Mbrojtja e veçantë ligjore**

Kur punonjësit ose ish-punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit, për shkak të detyrës që kryen ose ka kryer, i rrezikohet apo i dëmtohet jeta, shëndeti, familja ose prona, shteti i garanton mbrojtje të veçantë. Kushtet dhe masa e kompensimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 36
**E drejta për trajtim shëndetësor**

1. Punonjësi i Shërbimit Informativ të Shtetit në detyrë, në lirim, në pension, pjesëtarët e familjes së tij dhe kursanti gëzojnë të drejtën e trajtimit shëndetësor nga shteti në institucionet mjekësore shtetërore, ushtarake dhe civile, ose në qendrat mjekësore private brenda vendit.
2. Punonjësi i Shërbimit Informativ të Shtetit në detyrë, në lirim, në pension, pjesëtarët e familjes së tij dhe kursanti, kur është e nevojshme të kurohen ose të diagnostikohen jashtë vendit, kanë të drejtën të përfitojnë dhe të trajtohen sipas marrëveshjeve të lidhura për këtë qëllim nga shteti shqiptar, me kërkesën e Drejtorit të këtij Shërbimi.
3. Drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit ka të drejtë të lidhë marrëveshje për kurimin e punonjësit në detyrë, në lirim, në pension ose për pjesëtarët e familjes së tij, me shërbimet partnere të vendeve të huaja, duke respektuar legjislacionin për marrëveshjet dhe traktatet ndërkombëtare.
4. Shpenzimet, që rrjedhin nga zbatimi i këtij neni, përballohen nga Buxheti i Shtetit.
5. Kriteret dhe masa e përfitimit të trajtimit shëndetësor caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 37
**Kompensimi i barnave mjekësore**

1. Punonjësit të SHISH-it në detyrë, në lirim ose në pension, barnat mjekësore, të përfshira në listën e miratuar nga Këshilli i Ministrave, i rimbursohen në masën 80 për qind, nëse në akte të tjera nuk parashikohet një përqindje tjetër më e lartë.
2. Nga ky nen nuk përfitojnë punonjësit e përjashtuar nga SHISH-i. Forma dhe kriteret e rimbursimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU IV
MBROJTJA SHOQËRORE

Neni 38
**Ndihma financiare**

1. Kur bashkëshortja/bashkëshorti humbet vendin e punës, për shkak të emërimit ose transferimit në detyrë jashtë vendbanimit të përhershëm të punonjësit, këtij të fundit i jepet një shtesë page në masën dhe sipas kritereve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

Paga e papunësisë jepet në emër të bashkëshortes /bashkëshortit.

2. Koha e qëndrimit pa punë e bashkëshortes/bashkëshortit të punonjësit, për një periudhë deri në 7 vjet, njihet si vjetërsi sigurimi, për efekt përfitimi pensioni pleqërie. Kontributi për këtë periudhë përballohet nga Buxheti i Shtetit. Kriteret dhe masa përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Personat, të cilët e kanë përfituar këtë të drejtë para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë ta përfitojnë këtë pagesë edhe për periudhën e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, por jo më shumë se 15 vjet.

4. Bashkëshortja/bashkëshorti i punonjësit e përfiton pagën e papunësisë edhe për periudhën kur punonjësi nxirret në lirim ose vdes, por jo më shumë se periudha e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.

Neni 39
**Përparësia në punësim**

Kur punonjësi i Shërbimit Informativ të Shtetit bëhet i paaftë nga ana shëndetësore për të punuar në Shërbimin Informativ Shtetëror ose kur vendi i tij i punës shkurtohet, në kuadër të ristrukturimit, ai ka përparësi punësimi në një funksion të barazvlefshëm në administratën publike.

Neni 40
**E drejta për sigurim banese**

1. Punonjësit në detyrë të Shërbimit Informativ të Shtetit, që ka nevojë për strehim ose për sipërfaqe më të madhe banimi, i jepet kredi me kushte lehtësuese.

2. Punonjësi i Shërbimit Informativ të Shtetit, kur del në lirim ose në pension dhe ka nevojë për strehim ose për një sipërfaqe më të madhe banimi, trajtohet si punonjësi në detyrë.

3. Punonjësi i Shërbimit Informativ të Shtetit, i trajtuar sipas këtij neni, kur del në lirim dhe nuk i ka shlyer detyrimet përkatëse, vazhdon t’i shlyejë ato si punonjësit në detyrë.

4. Nuk përfitojnë, sipas këtij neni, punonjësit e përjashtuar nga SHISH-i.

5. Kriteret dhe masa e kredisë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 41
**Kompensimi për strehim**

1. Punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit i jepet kompensim për qira banese, kur nuk i sigurohet banesë nga Shërbimi Informativ i Shtetit.

2. Kriteret dhe masa e kompensimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 42
**Trajtimi i familjarëve të punonjësit, që humbet jetën në detyrë ose për shkak të detyrës**

1. Familja e punonjësit, që humbet jetën në detyrë ose për shkak të detyrës, përfiton pension familjar në masën 100 për qind të pagës mujore të muajit të fundit, pavarësisht nga periudha e sigurimit të të ndjerit.

2. Fëmijët e punonjësit, që ka humbur jetën në detyrë ose për shkak të detyrës, kur fitojnë të drejtën e ndjekjes së arsimit të lartë, përfitojnë nga shteti bursë të plotë, brenda planit të bursave, të miratuara nga Këshilli i Ministrave, për vitin akademik përkatës.

3. Fëmijët e punonjësit, që ka humbur jetën në detyrë ose për shkak të detyrës, kanë të drejtën e zgjedhjes së arsimit të mesëm, për shkollat e mesme, për të cilat nuk zhvillohet konkurs. Kërkesa paraqitet nga Drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit dhe miratohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës. Në këto raste fëmija trajtohet me bursë të plotë, brenda planit të bursave, të miratuara nga Këshilli i Ministrave, për vitin shkollor përkatës.

Neni 43

**Trajtimi në rastet e lirimit për shkak dëmtimi**

1. Kur punonjësi i SHISH-it lirohet nga shërbimi, si rezultat i një dëmtimi fizik ose mendor, në detyrë ose për shkak të detyrës, duke humbur plotësisht aftësinë për punë, përfiton pension në masën 100 për qind të pagës mujore të punonjësit në detyrë.

2. Kur punonjësi i SHISH-it lirohet nga shërbimi për arsye shëndetësore, përfiton trajtim financiar për një periudhë të caktuar, deri në punësimin e tij ose deri në daljen në pension pleqërie. Kriteret, periudha e përfitimit dhe masa përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Personat, të cilët plotësojnë kushtet e përcaktuara në ligjin për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve, për pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, kanë të drejtën e zgjedhjes ndërmjet këtij trajtimi financiar dhe pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi.

4. Punonjësi ka të drejtën e zgjedhjes së përfitimit të pensionit, sipas pikës 1 të këtij neni, ose sipas nenit 14 të ligjit nr. 8087, datë 13.3.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosuara të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ të Shtetit", të ndryshuar.

Neni 44

**Ndihma financiare në raste vdekjeje, sëmundjeje ose fatkeqësie**

1. Kur punonjësi në detyrë i SHISH-it vdes, sëmuret rëndë e për një kohë të gjatë, të vërtetuar me raport mjekësor, ose pëson dëmtime të rënda të pronës, si rezultat i një fatkeqësie natyrore, familjes ose atij i jepet ndihmë financiare e menjëhershme në masën deri në 6 paga mujore.

2. Kur punonjësi i SHISH-it në detyrë, në lirim ose në pension vdes, shërbimi organizon ceremoninë e rastit dhe ndihmon që punonjësi të varroset ku dëshiron familja.

3. Punonjësit të SHISH-it i jepet ndihmë financiare e menjëhershme në masën deri në 3 paga mujore, kur njëri nga familjarët në ngarkim të tij është i sëmurë rëndë dhe për një kohë të gjatë ose vdes.

4. Kur kursanti vdes gjatë kohës së trajnimit, familjes i jepet një ndihmë financiare e menjëhershme në masën deri në 4 paga mujore.

5. Punonjësi i aktivizuar barazohet me punonjësin në detyrë për efekt të trajtimit, sipas rasteve të parashikuara në pikat 1 e 2 të këtij neni.

KREU V

NDËRPRERJA E MARRËDHËNIEVE TË PUNËS

Neni 45

**Lirimi nga shërbimi**

Punonjësi i Shërbimit Informativ të Shtetit lirohet me urdhër të Drejtorit të këtij Shërbimi, kur:

a) jep dorëheqjen. Në këtë rast Drejtori duhet të shprehet brenda 30 ditëve nga kërkesa për dorëheqje;

b) mbush moshën për pension të plotë pleqërie;

c) mbush moshën për pension të parakohshëm dhe kërkon të largohet nga ky Shërbim;

ç) bëhet i paaftë përgjithmonë nga ana shëndetësore, të vërtetuar me vendim të komisionit mjekësor;

d) bëhen shkurtime, në kuadër të ristrukturimit, dhe kur nuk mund të sistemohet në një vend tjetër pune, brenda këtij Shërbimi;

dh) vlerësohet i paaftë në realizimin e detyrës së ngarkuar, të paktën, pas dy vlerësimeve të njëpasnjëshme të rezultateve në punë, të mbështetura edhe nga njësia e ngarkuar me funksionet e inspektimit;

e) nuk pranon të transferohet dhe bën kërkesë për të dalë në lirim.

Neni 46
**Disiplina**

1. Punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit i jepet masë disiplinore për mosplotësimin e detyrave, për thyerje të disiplinës në punë dhe të rregullave të etikës, për shkelje të akteve ligjore e nënligjore, veprime që nuk përbëjnë vepër apo kundërvajtje penale, si dhe në rastet e tjera, të parashikuara nga ky ligj.

2. Masat disiplinore jepen sipas një procedure administrative, e cila garanton të drejtën për t'u vënë në dijeni, për t'u dëgjuar, për t'u mbrojtur dhe për t'u ankuar. Drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit miraton rregulloren e disiplinës, kërkesat e së cilës janë të detyrueshme për zbatim nga të gjithë punonjësit.

Neni 47
**Llojet e masave disiplinore**

Llojet e masave disiplinore janë:

a) vërejtje me shkrim;

b) vërejtje me paralajmërim;

c) pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë për një periudhë deri në dy vjet;

ç) kalim në një detyrë të një niveli ose klase më të ulët, për një periudhë deri në 1 vit;

d) shkarkim nga detyra dhe kalim në një detyrë tjetër, më të ulët;

dh) përjashtim nga Shërbimi.

Neni 48
**Autoriteti për dhënien e masës disiplinore dhe shlyerja e saj**

1. Fillimi i procedimit disiplinor për shkronjat "a" e "b" të nenit 47 bëhet nga eprori direkt i punonjësit, ndërsa për shkronjat "c", "ç", "d" e "dh" të nenit 47, nga Drejtori i SHISH-it, mbështetur edhe në mendimet e njësisë së ngarkuar me funksionet e inspektimit.

2. Masa disiplinore mund të shlyhet brenda gjashtë muajve nga data e dhënies, për shkronjat "a" e "b", dhe brenda dy vjetëve nga data e dhënies, për shkronjat "c", "ç" e "d" të nenit 47, kur për punonjësin nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore.

3. Masa disiplinore e shlyer hiqet nga dosja vetjake e punonjësit.

Neni 49
**Komisioni disiplinor**

Me urdhër të Drejtorit të Shërbimit Informativ të Shtetit krijohet komisioni disiplinor për shqyrtimin e ankesave të punonjësve të këtij Shërbimi për masat disiplinore të përmendura në nenin 47. Në përfundim të shqyrtimit, komisioni disiplinor del me propozimet përkatëse para Drejtorit të Shërbimit, i cili vendos për marrjen, ndryshimin ose moszbatimin e masës.

Neni 50
**Njohja me dokumentacionin e procedimit**

1. Punonjësit të proceduar i jepet dokumentacioni i procedimit të nisur në ngarkim të tij në një afat jo më pak se 10 ditë para, për të pasur mundësi për të përgatitur mbrojtjen.

2. Punonjësi i proceduar njoftohet për datën kur do të shqyrtohen materialet, që lidhen me të.

Neni 51
**E drejta për t'u dëgjuar**

1. Punonjësi, ndaj të cilit ka nisur procedimi disiplinor, ka të drejtë të mbrohet, duke u paraqitur vetë para komisionit, i cili është i detyruar ta dëgjojë dhe të verifikojë pretendimet e ngritura.

2. Mosparaqitja pa shkaqe të arsyeshme e punonjësit të këtij Shërbimi nuk e pengon komisionin të shqyrtojë çështjen dhe të nxjerrë përfundimet përkatëse.

Neni 52
**Shqyrtimi i mendimeve të komisionit disiplinor**

Për mendimet e dhëna nga komisioni për shkeljet disiplinore, Drejtori i SHISH-it shprehet brenda 15 ditëve nga paraqitja e këtyre mendimeve.

Neni 53
**Pezullimi nga SHISH-i**

1. Pezullimi është ndërprerja e përkohshme e marrëdhënieve të punës për periudhën sa zgjat arsyeja e ndërprerjes. Në mbarim të kësaj periudhe, punonjësi i Shërbimit Informativ të Shtetit rimerr vendin e punës në këtë Shërbim ose përjashtohet prej tij.

2. Punonjësi, me urdhër të Drejtorit të Shërbimit Informativ të Shtetit, pezullohet:

a) kur ndaj tij fillon ndjekja penale, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar;

b) kur ndaj tij fillon shqyrtimi nga ndonjë inspektim, i brendshëm ose i jashtëm, dhe qenia e tij në detyrë cenon objektivitetin e inspektimit. Në këtë rast afati i pezullimit përcaktohet nga Drejtori i këtij Shërbimi;

c) gjatë periudhës kur ushtron një funksion të papajtueshëm me detyrën, sipas dispozitave në fuqi.

3. Në rastet e parashikuara në pikën 2 shkronjat "a" dhe "b" të këtij neni, kur çështja penale pushohet ose kur me vendim gjykate të formës së prerë deklarohet i pafajshëm apo kur inspektimi ka përfunduar dhe punonjësi rimerr vendin e punës, atij i jepen pagat që nga çasti i pezullimit.

4. Periudha e kohës së pezullimit nga detyra njihet si vjetërsi shërbimi.

Neni 54
**Përjashtimi nga Shërbimi**

1. Shërbimi Informativ i Shtetit ndërpret marrëdhëniet e punës me punonjësin, duke e përjashtuar nga Shërbimi, kur dënohet me vendim të formës së prerë nga gjykata me heqje lirie për krimet e kryera me dashje.

2. Punonjësi i SHISH-it ka të drejtë të ankohet, brenda 30 ditëve nga data e komunikimit të urdhrit, te Drejtori, i cili, brenda 30 ditëve, është i detyruar të kthejë përgjigje. Në qoftë se nuk i kthehet përgjigje, atëherë ankuesi, brenda 30 ditëve, ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës.

KREU VI
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 55
**Nxjerrja e akteve nënligjore**

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 8, 22 pika 3, 26 pika 2, 27 pika 2, 29, 33, 34 pika 1, 35, 40 pikat 5 e 6 dhe 41 pika 2 të këtij ligji.

2. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 24 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 36 pika 5, 37 pika 3 dhe 38 pikat 1 e 2. Në zbatim të neneve 24 e 25 të këtij ligji, të paraqesë ndryshimet përkatëse në ligjin nr.8087, datë 13.3.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ të Shtetit", të ndryshuar.

3. Ngarkohet Ministri i Financave, Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale dhe Drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrin udhëzimin e përbashkët në zbatim të pikës 5 të nenit 23 të këtij ligji.

4. Ngarkohet Drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 5 pika 7, 7 pika 1, 9 pika 4, 28 pika 3, 32 pika 1, 46 pika 2 dhe 49 të këtij ligji.

Neni 56
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4531, datë 13.4.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu**

**LIGJ**
**Nr. 9358, datë 24.3.2005**

**PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES FINANCIARE NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT TË KOMUNITETEVE EUROPIANE, PËR PROGRAMIN VJETOR KOMBËTAR TË VEPRIMIT, CARDS 2004"**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane, për Programin Vjetor Kombëtar të Veprimit, CARDS 2004".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4532, datë 13.4.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu**

MARRËVESHJE FINANCIARE
KUSHTET SPECIALE

Komiteti Europian, këtu e tutje referuar si "Komuniteti", i përfaqësuar nga Komisioni i Komiteteve Europiane, këtu e tutje referuar si "Komisioni", nga njëra anë dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë, këtu e tutje referuar si "Përfituesi", nga ana tjetër,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
**Natyra dhe qëllimi i veprimit**

1.1 Komuniteti do të kontribuojë për financimin e programit "Programi vjetor i veprimit, CARDS 2004 për Shqipërinë" këtu tutje referuar si "Programi", i cili është përshkruar në dispozitat teknike dhe administrative në shtojcën II.

1.2 Ky program do të zbatohet në përputhje me Marrëveshjen Financiare dhe shtojcat e saj: kushtet e përgjithshme (shtojca I) dhe dispozitat teknike dhe administrative (shtojca II).

Qeveria nuk do të ndryshojë destinacionin dhe përdorimin fillestar dhe/ose të synuar të pajisjeve të dërguara, ambienteve dhe godinave të restauruara pjesërisht dhe/ose plotësisht me fondet e Komitetit, përveç rastit kur bihet dakord ndryshe me Komisionin.

Neni 2
**Kontributi financiar i Komunitetit**

2.1 Kostoja totale e programit është 58 500 000 euro.

2.2 Komuniteti merr përsipër financimin e një shume jo më të madhe se 58.5 milionë euro. Ndarja e kontributit financiar të Komunitetit sipas zërave të buxhetit është përshkruar në buxhetin e përfshirë në dispozitat teknike dhe administrative në shtojcën II.

Neni 3
**Kontributi i Përfituesit**

Aty ku një pjesë apo i gjithë kontributi i Përfituesit është i një natyre jofinanciare, rregullat e detajuara do të përcaktohen në një memorandum mirëkuptimi të veçantë në lidhje me çdo program/projekt.

Neni 4
**Periudha e zbatimit**

Periudha e zbatimit të Marrëveshjes Financiare do të fillojë në momentin e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes Financiare dhe do të përfundojë, e shumta, në datën 31.12.2011. Kjo periudhë zbatimi do të përfshijë dy faza: një fazë operative të zbatimit, e cila do të fillojë në momentin e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes Financiare dhe do të përfundojë në datën 31.12.2009. Nga kjo datë do të fillojë faza e mbylljes, e cila do të përfundojë në fund të periudhës së zbatimit.

Neni 5
**Afati për nënshkrimin e kontratave të zbatimit të Marrëveshjes Financiare**

Kontratat e zbatimit të Marrëveshjes Financiare do të nënshkruhen, e shumta, brenda datës 15.9.2007. Ky afat nuk mund të shtyhet.

Neni 6
**Adresat**

Të gjitha komunikimet në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes Financiare do të jenë të shkruara, do t'i referohen shprehimisht programit dhe do të dërgohen në adresat e mëposhtme:

a) për Komisionin:
Komisioni i Komiteteve Europiane
Zyra Europiane e Ndimës dhe e Bashkëpunimit (L41 4/2)
Z.G.Quince, Drejtor
B-1049 Bruksel, Belgjikë
Fax: +32 2 295 74 82

b) për Përfituesin:
Znj. Ermelinda Meksi
Ministër i Integrimit Europian
Buleverdi "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë, Shqipëri
Fax: +355 4 25 62 67

Neni 7
**Shtojcat**

7.1 Dokumentet e mëposhtme do t'i bashkëngjiten kësaj Marrëveshjeje dhe do të përbëjnë pjesë integrale të saj:
Shtojca I: Kushtet e përgjithshme
Shtojca II: Dispozitat teknike dhe administrative

7.2 Në rast të një konflikti midis dispozitave të shtojcave dhe atyre të kushteve speciale të Marrëveshjes Financiare, dispozitat e kushteve speciale do të kenë përparësi. Në rast të një konflikti midis dispozitave të shtojcës I dhe atyre të shtojcës II, dispozitat e shtojcës I do të kenë përparësi.

Neni 8
**Kushte të tjera speciale të zbatueshme për programin**

8.1 Kushtet e përgjithshme plotësohen nga dispozitat e mëposhtme:

8.1.1 Programi do të zbatohet nga shërbimet e Komisionit në emër të dhe në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet kombëtare dhe/ose lokale të interesuara.

8.1.2 Zbatimi i decentralizuar nga autoritetet shqiptare mund të konsiderohet për një nga projektet e programet: Programi i Zhvillimit të Komuniteteve Lokale. Vendimi për decentralizimin e zbatimit do të merret me anë të një shkëmbimi letrash midis Komisionit dhe Përfituesit.

Neni 9
**Hyrja në fuqi e Marrëveshjes Ffinanciare**

Marrëveshja Financiare do të hyjë në fuqi në datën në të cilën ajo do të nënshkruhet nga pala e fundit.

Bërë në dy kopje origjinale në gjuhën angleze, një kopje për Komisionin dhe një kopje për Përfituesin.

Për Komisionin
Z.G. Quince (firma)
Drejtor
Zyra e Bashkëpunimit Europe Aid
Bruksel, më 5.10.2004

Për Përfituesin:
Znj. Ermelinda Meksi
Ministër i Integrimit Europian

Tiranë, më

Rezervë: Për sa i përket nenit 9, kjo Marrëveshje Financiare do të hyjë në fuqi për palën shqiptare në ditën e hyrjes në fuqi të ligjit për ratifikimin e saj nga Kuvendi i Shqipërisë.

Ministri i Integrimit Europian
**Ermelinda Meksi**

## SHTOJCA I
## KUSHTET E PËRGJITHSHME

## TITULLI I
## FINANCIMI I PROJEKTIT/PROGRAMIT

### Neni 1
### Parime të përgjithshme

1.1 Kontributi financiar i Komunitetit do të kufizohet nga shuma e përcaktuar në Marrëveshjen Financiare.

1.2 Dhënia e financimit nga Komuniteti do të kushtëzohet nga plotësimi i detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje Financiare nga ana e Përfituesit.

### Neni 2
### Tejkalimi i kostove dhe mbulimi i tyre

2.1 Tejkalimet individuale të zërave të buxhetit të Marrëveshjes Financiare do të trajtohen me anë të rishpërndarjes së fondeve të buxhetit të përgjithshëm, në përputhje me nenin 17 të këtyre kushteve.

2.2 Në qoftë se ekziston një rrezik i tejkalimit të shumës totale të përcaktuar në Marrëveshjen Financiare, Komisioni mund ose të zvogëlojë projektin/programin, ose të kërkojë angazhimin e burimeve financiare të Përfituesit apo burime të tjera jokomunitare.

2.3 Në qoftë se projekti/programi nuk mund të zvogëlohet ose në qoftë se tejkalimi nuk mund të mbulohet as nga fondet e Përfituesit apo burime të tjera, Komisioni mund të japë, në mënyrë të jashtëzakonshme, financime komunitare shtesë. Në këtë rast, kostot shtesë do të financohen pa cenuar rregullat dhe procedurat e Komunitetit, duke çelur një kontribut financiar shtesë, i cili do të përcaktohet nga Komisioni.

## TITULLI II
## ZBATIMI

### Neni 3
### Parime të përgjithshme

3.1 Projekti/programi do të zbatohet nga Komisioni duke vepruar për dhe në emër të Përfituesit.

3.2 Komisioni do të përfaqësohet në shtetin e Përfituesit nga kryetari i delegacionit të tij.

Neni 4
**Periudha e zbatimit**

4.1 Periudha e zbatimit të Marrëveshjes Financiare do të fillojë me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes Financiare dhe do të përfundojë në datën e përcaktuar në nenin 4 të kushteve specifike.

4.2 Kjo periudhë zbatimi do të përfshijë dy faza:

- një fazë operative zbatimi, ku kryhen veprimtaritë kryesore. Kjo fazë do të fillojë me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes Financiare dhe do të përfundojë 24 muaj përpara fundit të kohës së zbatimit;

- faza e mbylljes gjatë së cilës do të kryhen kontrollet finanaciare dhe vlerësimi, si dhe do të mbyllen teknikisht dhe financiarisht kontratat për zbatimin e Marrëveshjes Financiare. Kjo fazë do të fillojë në datën e përfundimit të fazës operative të zbatimit dhe do të përfundojë e shumta 24 muaj pas kësaj date.

4.3 Kostot që rrjedhin nga aktivitetet kryesore do të jenë të pranueshme për financimin e Komunitetit vetëm në qoftë se ato kanë lindur gjatë fazës operative të zbatimit. Kostot që rrjedhin nga kontrolli financiar përfundimtar, vlerësimi dhe mbyllja e aktiviteteve do të jenë të pranueshme deri në fund të fazës së mbylljes.

4.4 Çdo fond i mbetur nga kontributi i Komunitetit do të fshihet automatikisht gjashtë muaj pas përfundimit të periudhës së zbatimit.

4.5 Në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara siç duhet, mund të paraqitet një kërkesë për zgjatjen e fazës operative të zbatimit dhe, rrjedhimisht, të periudhës së zbatimit. Në qoftë se zgjatja e afatit kërkohet nga Përfituesi, kërkesa duhet të paraqitet të paktën tre muaj përpara përfundimit të fazës operative të zbatimit dhe të miratohet nga Komisioni përpara kësaj date.

4.6 Në rast të jashtëzakonshme dhe të justifikuara siç duhet dhe pas përfundimit të fazës operative të zbatimit, mund të paraqitet një kërkesë për zgjatjen e afatit të fazës së mbylljes dhe rrjedhimisht të periudhës së zbatimit. N.q.s zgjatja e afatit kërkohet nga Përfituesi, kërkesa duhet të paraqitet të paktën tre muaj përpara përfundimit të fazës së mbylljes dhe të miratohet nga Komisioni përpara kësaj date.

TITULLI III
LIDHJA E KONTRATAVE DHE DHËNIA E GRANTEVE

Neni 5
**Parime të përgjithshme**

Të gjitha kontratat e zbatimit të Marrëveshjes Financiare duhet të lidhen në përputhje me procedurat dhe dokumetet standarde të përcaktuara dhe të publikuara nga Komisioni për zbatimin e operacioneve të jashtme, në fuqi, në momentin e nisjes së procedurave në fjalë.

Neni 6
**Afati përfundimtar për nënshkrimin e kontratave të zbatimit të Marrëveshjes Financiare**

6.1 Kontratat e zbatimit të Marrëveshjes Financiare duhet të nënshkruhen nga të dyja palët brenda tre vjetësh nga miratimi i angazhimit buxhetor nga Komisioni, pra e shumta deri në datën e caktuar në nenin 5 të kushteve specifike. Ky afat nuk mund të shtyhet.

6.2 Norma e mësipërme nuk do të aplikohet për kontratat e kontrollit financiar dhe të vlerësimit, të cilat mund të nënshkruhen edhe më vonë.

6.3 Në datën e përmendur në nenin 5 të kushteve specifike, çdo fond për të cilin nuk është nënshkruar ndonjë kontratë nuk janë nënshkruar, do të fshihet.

6.4 Çdo kontratë për të cilën nuk ka filluar asnjë pagesë brenda tre vjetësh nga nënshkrimi i saj do të përfundojë automatikisht dhe fondet e saj do të fshihen.

Neni 7
**Pranueshmëria**

7.1 Pjesëmarrja në ftesat për tenderat për kontratat për punime, furnizime ose shërbime është hapur në kushte barabarta për të gjithë pesonat fizikë dhe juridikë të shteteve anëtare të Komunitetit dhe në përputhje me kushtet specifike të akteve bazë rregulluese të sektorëve të interesuar të bashkëpunimit, për të gjithë personat fizikë dhe juridikë të vendeve të treta përfituese ose të çdo vendi tjetër të tretë të përcaktuar shprehimisht në këto akte.

7.2 Pjesëmarrja në konkurset për propozimet është e hapur në kushte të barabarta për të gjithë personat fizikë dhe juridikë të shteteve anëtare të Komunitetit dhe në përputhje me kushtet specifike të akteve bazë rregulluese të sektorëve të interesuar të bashkëpunimit, për të gjithë personat fizikë dhe juridikë të vendeve të treta përfituese ose të çdo vendi të tjetër tretë të përcaktuar shprehimisht në këto akte.

7.3 Në mënyrë të jashtëzakonshme, në raste të justifikuara të miratuara nga Komisioni, mund të vendoset që, në bazë të kushteve specifike të përcaktuara në aktet bazë rregulluese të sektorëve të interesuar të bashkëpunimit, të lejohen shtetasit e vendeve të treta, të ndryshëm nga ata të përcaktuar në paragrafin 1 dhe 2 të marrin pjesë në tenderat për kontrata.

7.4 Mallrat dhe furnizimet e financuara nga Komiteti dhe të nevojshme për përmbushjen e kontratave të punimeve, furnizimeve dhe shërbimeve, si dhe të procedurave të prokurimit të nisura nga përfituesi i grantit për zbatimin e aktivitetit të financuar, duhet të kenë origjinën e tyre në vende të pranueshme për të marrë pjesë, siç përcaktohet në 3 paragrafët e mësipërm.

7.5 Ky rregull i kombësisë do të aplikohet gjithashtu për ekspertët e propozuar nga ofruesit e shërbimeve, të cilët do të marrin pjesë në procedurat e tenderave ose në kontratat e shërbimeve të financuara nga Komuniteti.

TITULLI IV
RREGULLAT E ZBATUESHME PËR PËRMBUSHJEN E KONTRATAVE

Neni 8
**E drejta e vendosjes dhe e qëndrimit**

8.1 Kur justifikohet nga natyra e kontratës, personat fizikë dhe juridikë që marrin pjesë në ftesat për tender për kontratat e punimeve, furnizimeve ose shërbimeve do të gëzojnë të drejtën e përkoshme të vendosjes dhe të qëndrimit në vendin e Përfituesit. Kjo e drejtë do të jetë e vlefshme për një muaj pas dhënies së kontratës.

8.2 Kontraktorët (duke përfshirë Përfituesin e grantit) dhe personat fizikë, shërbimet e të cilëve janë të nevojshme për përmbushjen e kontratave, si dhe anëtarët e familjeve të tyre do të gëzojnë të drejta të ngjashme gjatë zbatimit të projektit/programit.

Neni 9
**Normat tatimore dhe doganore**

9.1 Tatimet, detyrimet doganore dhe detyrime të tjera (duke përfshirë TVSH-në ose taksat ekuivalente) do të jenë të përjashtuara nga financimi i Komunitetit.

9.2 Shteti përfitues duhet të aplikojë për kontratat e prokurimeve dhe grantet e financuara nga Komuniteti normat tatimore dhe doganore më të favorizuara, të aplikuara për shtetet ose organizatat e zhvillimit ndërkombëtar me të cilat ai ka marrëdhënie.

9.3 Aty ku Marrëveshja kuadër ose shkëmbimi i letrave të aplikueshme përfshin norma më të detajuara mbi këtë çështje, ato duhet të aplikohen gjithashtu.

Neni 10
**Normat mbi kursin e këmbimit**

10.1 Shteti përfitues merr përsipër të autorizojë importin ose blerjen e valutës së huaj të nevojshme për zbatimin e projektit. Ai merr përsipër gjithashtu të aplikojë normativën e tij kombëtare për kërkimin e valutës në një mënyrë jodiskriminuese për kontraktorët që lejohen të marrin pjesë sipas nenit 7 të këtyre kushteve.

10.2 Aty ku Marrëveshja kuadër ose shkëmbimi letrave të aplikueshme përfshin norma më të detajuara mbi këtë çështje, ato duhet të aplikohen gjithashtu.

Neni 11
**Përdorimi i të dhënave nga studimet**

Aty ku Marrëveshja Financiare përfshin financimin e një studimi, kontratat në lidhje me këtë studim, nënshkruar për zbatimin e Marrëveshjes Financiare, duhet të rregullojnë pronësinë e këtij studimi, si dhe të drejtat e Përfituesit ose të Komisionit për të përdorur të dhënat në studim, për ta publikuar atë ose për t'ua dhënë palëve të treta.

Neni 12
**Alokimi i fondeve të rikthyera nga kontratat**

12.1 Fondet e rikthyera nga pagesat e kryera gabimisht, nga garancitë e pagesave parafinancuese ose nga përfitimet që rrjedhin nga garancitë e ofruara në bazë të kontratave të financuara sipas kësaj Marrëveshjeje Financiare, duhet të alokohen për projektin/programin.

12.2 Ndëshkimet financiare të vendosura nga autoriteti kontraktues ndaj një kandidati apo pjesëmarrësi në tender, i cili hyn në rastet e përjashtimit në kuadrin e një kontrate prokurimi, kërkesa për garancitë e tenderit, si dhe dëmet që i shkaktohen Komisionit do t'i ripaguhen buxhetit të përgjithshëm të Komuniteteve Europiane.

TITULLI V
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 13
**Transparenca**

13.1 Çdo projekt/program, financuar nga Komuniteti, do të jetë objekt i operacioneve të përshtatshme informuese dhe komunikuese. Këto veprime do të përcaktohen me miratimin e Komisionit.

13.2 Këto operacione informuese dhe komunikuese duhet të kryhen sipas rregullave të përcaktuara e të publikuara nga Komisioni për transparencën e aktiviteteve të jashtme në fuqi, në momentin e kryerjes së këtyre veprimeve.

Neni 14
**Parandalimi i parregullsive, mashtrimit dhe korrupsionit**

14.1 Përfituesi duhet të marrë masat e përshtashme për të parandaluar parregullsitë dhe mashtrimet ose dhe me kërkesë të Komisionit, të nisë ndjekjet penale për rikthimin e fondeve të paguara gabimisht. Përfituesi do të informojë Komisionin për çdo masë të marrë.

14.2 "Parregullsi" do të thotë çdo shkelje e Marrëveshjes Financiare, kontratave të zbatimit ose e së drejtës komunitare, i cili shkaktohet si pasojë e një veprimi ose mosveprimi të një operatori ekonomik, dhe që ka ose do të kishte si efekt cenimin e buxhetit të përgjithshëm të Komuniteteve Europiane ose të buxheteve të administruara prej tyre, duke pakësuar ose duke humbur të ardhura që rrjedhin nga burime të tyre të mbledhura direkt në emër të Komuniteteve Europiane, ose nga çdo zë

i pajustifikuar shpenzimi.

"Mashtrim" do të thotë çdo veprim ose mosveprim i qëllimshëm, që lidhet me:

- përdorimin ose paraqitjen e dokumeteve ose deklaratave të rreme, jokorrekte ose të paplota, të cilat kanë si efekt të tyre përvetësimin ose mbajtjen e padrejtë të fondeve nga buxheti i përgjithshëm i Komuniteteve Europiane ose nga buxhete e administruara prej tyre ose në emër të tyre.

- mosdhënien e informacionit në kundërshtim dhe detyrimet specifike, me të njëjtin efekt;

- keqpërdorimin e këtyre fondeve për qëllime të tjera të ndryshme nga ato për të cilat janë ofruar fillimisht.

Përfituesi do të informojë menjëherë Komisionin për çdo element që sillet në vëmendjen e tij, i cili lë për të dyshuar për parregullsi ose mashtrim.

14.3 Përfituesi merr përsipër të ndërmarrë të gjitha masat e duhura për të ndrequr çdo praktikë korruptive, pasive ose aktive, çfarëdo qoftë ajo, në çdo fazë të procedurës për dhënien e kontratave ose granteve ose në zbatimin e kontratave që lidhen me të. "Korrupsion pasiv" do të thotë veprim i paramenduar i një nënpunësi, i cili direkt ose me anë të një ndërmjetësi, kërkon ose përfiton avantazhe të çdo lloji çfardo qoftë ky, për veten e tij ose për një palë të tretë, ose pranon një premtim për një përfitim të tillë për të vepruar ose për t'u shmangur nga veprimi në përputhje me detyrën e tij ose në ushtrimin e funksioneve të tij, duke shkelur detyrat e tij funksionale, veprim që ka ose do të kishte si efekt cenimin e interesave financiare të Komuniteteve Europiane. "Korrupsion aktiv" do të thotë veprim i paramenduar i cilatdo që, direkt apo nëpërmejt një ndërmjetësi, i premton ose i jep një avantazh të çdo lloji, çfardo qoftë ai, një nëpunësi për veten e tij ose për një palë të tretë, për të vepruar ose për t'u shmangur nga veprimi në përputhje me detyrën e tij ose në ushtrimin e funksioneve të tij, duke shkelur detyrat e tij funksionale, veprim që ka ose do të kishte si efekt cenimin e interesave financiare të Komuniteteve Europiane.

## Neni 15
## Verifikimet dhe kontrollet nga Komisioni, Zyra Europiane Kundër Mashtrimit (OLAF) dhe Gjykata e Kontrollit Financiar të Komuniteteve Europiane

15.1 Përfituesi bie dakord që Komisioni, OLAF dhe Gjykata e Kontrollit Financiar të Komuniteteve Europiane të kryejnë kontrolle dokumentacioni apo në vend mbi përdorimin që i është bërë financimit të Komunitetit sipas Marrëveshjes Financiare (duke përfshirë procedurat për dhënien e kontratave dhe granteve), si dhe të kryejnë një kontroll financiar të plotë, nëse e domosdoshme, në bazë të dokumenteve mbështetëse të llogarive dhe dokumenteve kontabël, si dhe të çdo dokumenti tjetër që lidhet me financimin e projektit/programit, gjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëveshjes, si dhe për shtatë vjet pas datës së pagesës së fundit.

15.2 Përfituesi bie dakord gjithashtu që OLAF mund të kryejë kontrolle në vend dhe verifikime në përputhje me procedurat e përcaktuara nga e drejta komunitare për mbrojtjen e interesave financiare të Komuniteteve Europiane kundër mashtrimit dhe parregullsive të tjera.

15.3 Për këtë qëllim, Përfituesi merr përsipër t'u japë nëpunësve të Komisionit, të OLAF dhe të Gjykatës së Kontrollit Financiar të Komuniteteve Europiane, si dhe përfaqësuesve të tjerë të autorizuar, mundësinë e hyrjes në vendet dhe ambientet në të cilat aktivitetet e financuara sipas Marrëveshjes Financiare janë kryer, duke përfshirë sistemet e tyre kompjuterike, si dhe çdo dokument ose të dhënë të informatizuar që lidhet me administrimin teknik dhe financiar të këtyre aktiviteteve, si dhe të marrë përsipër çdo masë që është e nevojshme për të lehtësuar punën e tyre. Kjo mundësi hyrjeje për përfaqësuesit e autorizuar të Komisionit Europian të OLAF dhe Gjykatës së Kontrollit Financiar të Komuniteteve Europiane do të jepet në kushtet e një kofidencialiteti të plotë lidhur me palët e treta, duke mos cenuar detyrimet që rrjedhin nga e drejta publike të cilave ato i nënshtrohen. Dokumentet duhet të jenë të konsultueshme dhe të arkivuara në një mënyrë që të lejojë inspektim të lehtë të tyre. Përfituesi është i detyruar të njoftojnë Komisionin OLAF ose Gjykatën e Kontrollit Financiar të Komuniteteve Europiane për vendin e saktë ku ruhen këto dokumente.

15.4 Kontrollet dhe kontrollet financiare të përmendura më sipër do të aplikohen edhe për kontraktorët dhe nënkontraktorët të cilët kanë përfituar financime të Komunitetit.

15.5 Përfituesi do të njoftohet mbi misionet e kontrollit në vend nga përfaqësuesit e emëruar nga Komisioni, OLAF ose Gjykata e Llogarive.

Neni 16
**Konsultimet midis Komisionit dhe Përfituesit**

16.1 Përfituesit dhe Komisioni do të konsultojnë njëri-tjetrin përpara paraqitjes së çdo mosmarrëveshjeje në lidhje me zbatimin ose interpretimin e kësaj Marrëveshjeje Financiare.

16.2 Konsultimet mund të çojnë në ndryshimin, ndërprerjen ose përfundimin e Marrëveshjes Financiare.

Neni 17
**Ndryshimet në Marrëveshjen Financiare**

17.1 Çdo ndryshim për shtojcën II të Marrëveshjes Financiare do të bëhet me shkrim dhe do të jetë objekt i një shtojce.

17.2 Në qoftë se kërkesa për një ndryshim vjen nga Përfituesi, ky i fundit duhet t'ia paraqesë kërkesën Komisionit të paktën tre muaj përpara datës së propozuar për hyrjen në fuqi të shtojcës, me përjashtim të rasteve të justifikuara siç duhet nga Përfituesi dhe të pranuara nga Komisioni.

17.3 Rastet specifike të zgjatjes së afatit të fazës operative të zbatimit të fazës së mbylljes janë të rregulluara nga neni 4 (5) dhe (6) i këtyre kushteve.

Neni 18
**Pezullimi i Marrëveshjes Financiare**

18.1 Marrëveshja Financiare mund të pezullohet në rastet e mëposhtme:

a) Komisioni mund të pezullojë zbatimin e Marrëveshjes Financiare në qoftë se Përfituesi shkel detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja Financiare.

b) Komisioni mund të pezullojë Marrëveshjen Financiare në qoftë se Përfituesi shkel një detyrim që lidhet me të drejtat e njeriut, parimet demokratike dhe shtetin e së drejtës, dhe në rastet serioze të korrupsionit.

c) Marrëveshja Financiare mund të pezullohet për shkak të një force madhore, siç përcaktohet më poshtë. "Forcë madhore" do të thotë një situatë e paparashikueshme dhe e jashtëzakonshme ose ngjarje përtej kontrollit të palëve, e cila pengon palët në përmbushjen e çdo detyrimi, dhe që nuk mund të ngarkohet një gabim ose pakujdesie të tyre (ose kotraktorëve të tyre, përfaqësuesve ose punonjësve), si dhe provohet të jetë e pakapërcyeshme pavarësisht nga përpjekjet që mund të bëhen. Difektet në pajisje ose materiale, ose vonesat për t'i bërë të disponueshme, mosmarrëveshjet e punës, grevat dhe vështirësitë financiare nuk mund të konsiderohen si forcë madhore. Një palë nuk do të konsiderohet në shkelje të detyrimeve të saj në qoftë se nuk ka mundur të përmbushë ato për shkak të një force madhore. Një palë që ballafaqohet me një forcë madhore duhet të informojë pa vonesë palën tjetër, duke deklaruar natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektet e parashikuara të problemit. Gjithashtu, ajo duhet të marrë çdo masë për të minimizuar dëmet e mundshme.

18.2 Asnjë njoftim paraprak nuk do të jepet për vendimin e pezullimit.

18.3 Në momentin e njoftimit të pezullimit, do të tregohen edhe pasojat mbi kontratat në fuqi ose kontartat që janë ende për t'u firmosur.

Neni 19
**Përfundimi i Marrëveshjes Financiare**

19.1 Në qoftë se çështjet që shkaktojnë pezullimin e Marrëveshjes Financiare nuk zgjidhen për një periudhë katërmujore, çdo palë mund të mbarojë Marrëveshjen Financiare me dy muaj

paralajmërim.

19.2 Kur një Marrëveshje Financiare nuk ka filluar ndonjë pagesë brenda tre vjetësh nga nënshkrimi i saj ose kontratat e zbatimit nuk janë firmosur sipas datave të përcaktuara në nenin 5 të këtyre kushteve, atëherë Marrëveshja Financiare do të mbarojë automatikisht.

19.3 Në momentin e njoftimit të mbarimit, do të tregohen edhe pasojat mbi kontratat në fuqi ose kontratat që janë ende për t'u firmosur.

Neni 20

**Rregullat për zgjedhjen e mosmarrëveshjeve**

20.1 Çdo mosmarrëveshje në lidhje me Marrëveshjen Financiare, e cila nuk mund të zgjidhet brenda një periudhe gjashtëmujore nga konsultimet midis palëve sipas nenit 16 të këtyre kushteve, mund të zgjidhet me anën e arbitratit me kërkesën e njërës prej palëve.

20.2 Në këtë rast, secila nga palët do të caktojë arbitër brenda 30 ditësh nga paraqitja e kërkesës për arbitrat. Në qoftë se kjo nuk verifikohet, secila nga palët mund t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës së Përhershme të Arbitratit (Hagë) të caktojë një arbitër të dytë. Dy arbitrat, nga ana e tyre, do të caktojnë një arbitër të dytë. Dy arbitrat, nga ana e tyre, do të caktojnë një arbitër të tretë brenda 30 ditësh. Në qoftë se kjo nuk verifikohet, secila nga palët mund t'i kërkojnë Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës së Përhershme të Arbitratit të caktojë arbitrin e tretë.

20.3 Përveç rastit kur arbitrat vendosin ndryshe, do të aplikohen procedurat e përcaktuara në Rregullat Fakultative të Arbitrimit për Organizatat Ndërkombëtare dhe Shtetet të Gjykatës së Përhershme të Arbitratit. Vendimi i arbitrave do të merret me shumicë votash brenda një periudhe tremujore.

20.4 Secila palë do të jetë e detyruar të marrë masat e nevojshme për aplikimin e vendimit të arbitrave.

SHTOJCA II

MASAT TEKNIKE DHE ADMINISTRATIVE

1. PËRMBLEDHJA E PROGRAMIT

Në përputhje me dokumentin strategjik për Shqipërinë 2002-2006 (DS) dhe programin indikativ shumëvjeçar (PISH) 2002-2004, objektivi i përgjithshëm i programit CARDS kombëtar 2004 për Shqipërinë është mbështetje për pjesëmarrjen e Shqipërisë në procesin e stabilizim-asocimit (PSA), duke përfshirë kontributin për zhvillimin e përgjithshëm ekonomiko-shoqëror të vendit.

Si rrjedhim i kësaj, objektivat e detajuara të programit janë:

- sigurimi i rendit publik dhe i shtetit të së drejtës nëpërmjet forcimit të pushtetit gjyqësor dhe luftës kundër krimit të organizuar, mashtrimit financiar dhe korrupsionit;
- përmirësimi i funksionimit të shtetit dhe sigurimi i zbatimit të duhur të kuadrit ligjor, duke marrë parasysh edhe rritjen e sigurisë ligjore për individët dhe entet publike e private në Shqipëri;
- mbështetja për krijimin dhe funksionimin e një ekonomie tregu dhe nxitja e rritjes së sektorit privat dhe krijimite të vendeve të punës; të gjitha këto për të lehtësuar rritjen ekonomike të qëndrueshme, tregtinë dhe punësimin dhe për të siguruar integrimin e ekonomisë shqiptare me atë të BE-së dhe atë të komunitetit ndërkombëtar në përgjithësi;
- sigurimi i zbatimit të duhur prej Shqipërisë të marrëveshjes së ardhshme të stabilizim-asocimit me BE-në, si edhe përafrimi graduai legjislacionit dhe strukturave shqiptare me ato të BE-së;
- mbrojtja e mjedisit; dhe
- forcimi i shoqërisë civile dhe përmirësimi i mëtejshëm i sistemit/procesit zgjedhor.

Në përputhje me me këto objektiva të veçanta, me ndihmën e ofruar më parë nga PISH-i nevojat për fondet nga programit CARDS dhe masat specifike të orientuara kundër krimit të organizur në Ballkan (siç u propozuan në Këshillin e Selanikut dhe për të cilat u ra dakord në takimin misterial të zhvillimit në Bruksel në datën 28 nëntor 2003 për Drejtësinë dhe Punët e Brendshme), programi i vitit 2004 për Shqipërinë do të mbulojë fushat prioritare të mëposhtme:

| Fushat prioritare | Buxheti i propozur (M€) |
|---|---|
| Drejtësia dhe punët e brendshme | 34.0 |
| Forcimi i kapaciteteve administrative | 3.0 |
| Zhvillimi ekonomik dhe shoqëror | 12.0 |
| Mjedisi dhe burimet natyrore | 7.0 |
| Stabilizimi demokratik | 2.5 |
| TOTALI | 58.5 |

## 2. SITUATA NË VEND

Reformat në Shqipëri nga koha kur PISH-i u përgatit kanë qenë në përgjithësi të pamjaftueshme për të trajtuar sfidat e shumta me të cilat përballet vendi. Vetëm një numër i kufizuar i rekomandimeve të përfshira në raportin e PSA-së për vitin 2003 apo të dala nga takimet e Grupit të Posaçëm Këshillimor në dy vitet e fundit janë marrë parsysh ashtu siç duhet. Shqetësim të veçantë paraqesin për Shqipërinë çështjet që lidhen me konsolidimin e shtetit ligjor, si lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe funksionimi i sistemit gjyqësor. Ndërsa Shqipëria mund të vlerësohet për rolin e saj përgjithësisht konstruktiv në rajon, pakësimin e trafikut në Adriatik dhe përafrimin e Marrëveshjes së ripranimit me komunitetin, rezultatet në fusha kyç si lufta kundër korrupsionit e krimit të organizuar dhe reformat në sistemin gjyqësor e administratën publike nuk kanë arritur atë që pritej.

Klima politike nuk ka lejuar zbatimin e duhur të reformave. Stabiliteti i brishtë politik i arritur në vitin 2002 është zëvendësuar progresisht në tensione të forta jo vetëm ndërmjet partive kryesore politike, por gjithashtu edhe brenda vetë Partisë Socialiste (PS) qeverisëse. Lufta për kryesimin e PS-së ka ndikuar negativisht në stabilitetin e qeverisë. Duke qenë se vëmendja e qeverisë është përqendruar gjithnjë e më shumë në këto vështirësi të brendshme, programi i reformave ka vazhduar të ketë vonesa. Si pasojë, shumë difekte të identifikuara në raportin e vitit 2001 të Grupit Drejtues të Nivelit të Lartë, në raportet e PSA-së të viteve 2002 dhe 2003 dhe gjatë dialogut politik me autoritetet shqiptare, mbeten të pazgjidhura. Për shembull, rekomandimet specifike për procesin zgjedhor nuk janë trajtuar, siç u provua qartësisht gjatë zgjedhjeve vendore të 12 tetorit 2003. Aftësitë e përgjithshme të administratës publike për zbatimin e detyrimeve të Shqipërisë në përputhje me Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit (MSA) mbeten çështje shqetësuese.

Në fushën ekonomike, ka pasur në rritje reale të PBB-së prej 6%, në një kuadër inflacioni të ulët. Disa përparime janë bërë për sa i përket privatizimit të shoqërive në pronësi të shtetit (veçanërisht privatizimin e Bankës së Kursimeve), si dhe hapa paraprake janë ndërmarrë për të trajtuar çështjen e pronësisë mbi tokën. Megjithatë, paqëndrueshmëria politike, mungesa e përqendrimit në reformat, si dhe dështimi për sa i përket investimeve infrastrukturore aq të domosdoshme, kanë rrezikuar rritjen e qëndrueshme ekonomike dhe aftësinë e vendit për të lehtësuar varfërinë. Ekonomia shqiptare mbetet informale në një masë të konsiderueshme. Klima për sipërmarrjet nuk ka një përmirësim të mjaftueshëm për të inkurajuar investimet. Ndërhyrjet e korrupsionit, krimit të organizuar, si dhe ekzistenca e një administrate joefiçente vazhdojnë të jenë pengesë për krijimin dhe nxitjen e sipërmarrjeve. Siguria ligjore mbetet e pamjaftueshme dhe kuadri ligjor tregtar është i papërshtashëm për t'i shërbyer qëllimit të nxitjes së zhvillimit të sipërmarrjeve. Megjithë arritjen e marrëveshjeve të tregtisë së lirë (MTL) me vendet e rajonit, Shqipëria ka treguar gjithashtu edhe kufizimet e saj në zbatimin e plotë të kalendarit të saj të OBT-së.

## 3. NDIHMA E KALUAR E KE-së DHE MËSIMET E NXJERRA

| | Angazhuar (M€) | Kontraktuar (M€) | Disbursuar (M€) |
|---|---|---|---|
| CARDS 2001 | 37.50 | 25.48 | 12.90 |
| CARDS 2002 | 44.90 | 9.13 | 4.80 |
| CARDS 2003 | 46.50 | 5.04 | 1.31 |

Zbatimi i ndimës së KE-së për Shqipërinë si nga programi PHARE, ashtu edhe nga programi CARDS është përmirësuar në mënyrë të ndjeshme gjatë vitit 2003. Kjo për një numër arsyesh, më e rëndësishmja e të cilave është se Komisioni ka marrë përgjegjësinë për tenderimin dhe kontraktimin e disa projekteve të programit PHARE, si dhe është përfunduar procesi i decentralizimit, nëpërmjet të cilit përgjegjësia për tenderimin, kontraktimin dhe menaxhimin e programit CARDS është zhvendosur nga AIDCO në Bruksel e Delegacioni. Këto zhvillime kanë lejuar kontraktimin e pjesës më të madhe të projekteve të mbetura nga Programi PHARE si dhe të një numri të madh të programit CARDS 2001. Në vitin 2003, delegacioni ka qënë në gjendje të përfundojë fazën e detajimit (vlerësimit) për një numër të konsiderueshëm projektesh të programit CARDS 2002, gjë që do të mundësojë tenderimin dhe kontraktimin e tyre gjatë vitit 2004.

Komisioni Europian ka nxjerrë si mësim se për të siguruar angazhimin dhe qëndrueshmërinë afatgjatë, pavarësisht kalimit nga programi PHARE i menxhuar nga Shqipëria në Programin CARDS të menaxhuar nga KE-ja, është e nevojshme të bëhen të gjitha përpjekjet për të zhvilluar ndjenjën e pronësisë së projektit nga ana e Qeverisë. Ministria e Integrimit Europian-bashkëbiseduesi kryesor shqiptar-dhe Ministritë e Linjës duhet të jenë të përfshira plotësisht në të gjitha fazat e ciklit të projektit, duke përfshirë programimin dhe indentifikimin, kështu që ata të ndjejnë se kanë një zë në program. Në këtë drejtim, një përparim domethënë është bërë në përgatitjen e këtij programi veprimi, që konsiston në faktin se Ministria e Integrimit Europian luajti plotësisht rolin e saj kordinues për përgatitjen e kontributit shqiptar në këtë proces.

Së fundmi, orientimi i ri CARDS në drejtim të Drejtësisë dhe Punëve të Brendshme/forcimit të kapaciteteve administrative është shumë i vonët (zbatimi i programit të vitit 2001 është në vazhdim) për të mundësuar nxjerrjen e mësimeve nga projekte të mëparshme në këtë fushë.

## 4. KOMPONENTËT E PROGRAMIT

### 4.1 Fusha prioritare nr.1- Drejtësia dhe punët e brendshme

Situata

Mbështetja e reformës gjyqësore, policisë, luftës kundër krimit të organizuar dhe kapaciteteve të Shqipërisë për të menxhuar kufijtë e saj në një mënyrë të integruar-duke përshirë migrimin dhe azilin-janë të përmendura si prioritetet në DS dhe PISH. Të gjitha projektet e identifikuara janë përputhje me raporitn e PSA-së dhe rekomadimet e CTF-së, si dhe me raportin e vlerësimit në fushën e DPB-së për Ballkanin Perëndimor. Dy projekte të tjera për menaxhimin e kufirit kanë si qëllim të lehtësojnë tregtinë në kufi dhe janë si përgjigje e prioriteteve të përmendura në shtojcën VI të PISH-it.

#### 4.1.1 Reformat e pushtetit gjyqësor

Situata

Megjithë disa përmirësime të kufizuara, sistemi gjyqësor shqiptar mbetet përgjithësisht i dobët. Aftësitë profesionale të personelit gjyqësor në të gjitha nivelet janë përgjithësisht të pamjaftueshme, si dhe infrastruktura dhe pajisjet janë jo të përshtatshme. Kjo është veçanërisht e vërtetë në rastin e sistemit të burgjeve, ku kushtet në të cilat të burgosurit mbahen janë shpesh të tmerrshme, si dhe për një numër institucionesh të tjera që varen nga Ministria e Drejtësisë.

Disa shtesa dhe ndryshime në ligjet ekzistuese kanë trajtuar çështjet si ajo e pagës së gjykatësve dhe organizimit të gjykatave, duke përfshirë Këshillin e Lartë të Drejtësisë, i cili është organi përgjegjës për mbrojtjen, emërimin, transferimin, shkarkimin, formimin, vlerësimin profesional, karrierën dhe inspektimin e veprimtarisë së gjykatësve. Megjithatë, fatkeqësisht, kapaciteti i Këshillit të Lartë të Drejtësisë për të inspektuar efektivisht veprimtarinë e gjykatësve është disi i kufizuar.

Dy sektorë të veçantë të sistemit gjyqësor shqiptar kanë nevojë, gjithashtu të forcohen në përparësi; të miturit dhe çështjet tregtare. Mosekzistenca e një kuadri ligjor të përshtatshëm në këto dy sektorë dhe mungesa e sistemeve ligjore të specializuara për t'u marrë me fëmijët në konflikt me ligjin dhe me çështjet tregtare, kanë një ndikim negativ në gëzimin e të drejtave nga fëmijët dhe në zhvillimin ekonomik në përgjithësi.

Projektet e indentifikuara

1.REHABILITIMI I INSTITUCIONEVE TË VARURA NGA MINISTRIA E DREJTËSISË

Ky projekt do të ketë dy komponentë: përfundimi i ndërtimit të burgut të korçës (faza II)[1] dhe rehabilitimi i Qendrës së Publikimeve Zyrtare. Objektivi i përgjithshëm është i dyanshëm: përmirësimi i kushteve i të burgosurve shqiptarë dhe përmirësimi i përgjithshëm i njohurive të çështjeve legjislative në Shqipëri.

Objektivat specifike janë përmirësimi i kapaciteteve dhe i funksionimit të sistemit shqiptar të burgjeve, si dhe përmirësimi i mundësisë së konsultimit të publikimeve ligjore.

Këto objektiva do të arrihen nëpërmjet aktiviteteve që vijojnë : (1) përfundimi i punimeve të ndërtimit të filluar nga projekti "Ndërtimi i burgut të Fushë-Krujës-faza I", (2) ofrimi i mobilieve dhe i pajisjeve për ta bërë burgun plotësisht operacional, (3) mbështetje për shkollën e trajnimit të burgjeve, nëpërmjet analizës së nevojave për trajnime, zhvillimit të një plani trajnimi, kurseve, seminareve, tryezave të punës, vizitave studimore dhe aktiviteteve të "binjakëzimit" me institucione të sistemit të burgjeve në vendet e BE-së dhe (4) përgatitja e projektit dhe punimet e ndërtimit/rehabilitimit, si dhe ofrimi i pajisjeve për funksionimin e duhur të Qendrës së Publikimeve Zyrtare.

2.FORCIMI I KAPACITETEVE PËR HETIMIN DHE NDËSHKIMIN E KRIIMIT TË ORGANIZUAR

Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti është njëri prej objektivave të ashtuquajturave masa specifike të orientuara kundër krimit të organizuar, si dhe një vazhdim i natyrshëm i krimit kohët e fundit të Gjykatës për Krimet e Rënda[2].

Objektivi specifik i projektit është forcimi i sektorëve kyç për kapacitetet, për hetimin dhe ndëshkimin e krimit të organizuar.

Aktivitetet e projektit do të përfshijnë: (1) ndryshime dhe shtesa në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale dhe (2) rishikimin e Kodit Penal dhe të kuadrit ligjor në përputhje me Konventën e OKB-së mbi krimin e organizuar ndërkombëtar.

3.MBËSHTETJE PËR KËSHILLIN E LARTË TË DREJTËSISË DHE INSPEKTORIATIN E TIJ

Objektivi i përgjithshëm i projektit është rritja e pavarësisë së pushtetit gjyqësor në Shqipëri.

Objektivi specifik është përmirësimi i autoritetit, rritja e kapaciteteve dhe përmirësimi i funksionimit të KLD-së dhe inspektoratit të tij.

Aktivitetet kryesore do të jenë: (1) "binjakëzimi" ndërmjet KLD-së dhe një institucioni shtetëror të ngjashëm të BE-së, (2) organizimi i kurseve të trajnimit, tryezave të rrumbullakëta dhe seminareve, vizitave studimore dhe aktiviteteve në institucionet e BE-së dhe (3) ofrimi i mjeteve (për inspektimet në të gjithë vendin, pajisjeve të përshtatshme IT dhe pajisjeve për zyrat.

4. KRIJIMI I NJË SISTEMI GJYQËSOR PËR TË MITURIT DHE ÇËSHTJE TREGTARE

Objektivi i përgjithshëm i projektit është përmirësimi i administrimit të sistemit të drejtësisë për të miturit dhe për çështjet tregtare, në përputhje me standardet e BE-së dhe praktikat më të mira.

Objektivat specifikë të projektit janë: (1) mbështetja për zbatimin e një sistemi gjyqësor funksionues për të miturit, në përputhje me standardet e BE-së dhe instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut/fëmijëve, (2) harmonizmi i legjislacionit kombëtar për çështjet tregtare me standardet dhe praktikat më të mira të BE-së dhe (3) forcimi i funksionimit të seksioneve të specializuara për çështjet tregtare në gjykatat shqiptare.

Aktivitetet kryesore do të jenë: (1) përmirësimi i kuadrit ligjor, (2) mbështetja për krijimin e seksioneve të specializuara për drejtësinë për të miturit në gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit, (3) zhvillimi dhe zbatimi i një sistemi masash alternative të burgimit, (4) mbështetja për Drejtorinë e sapokrijuar të Drejtësisë për të Miturit dhe Ministrinë e Drejtësisë dhe (5) zhvillimi i një analize nevojash për trajnime, organizimi i seminareve, tryezave të punës, vizitave studimore dhe nismave të "binjakëzimit" në institucionet e BE-së që merren në çështjet e drejtësisë për të miturit.

---

[1] Faza është financuar nga Programi CARDS 2002

[2] Ndërtimi i godinës së re për këtë Gjykatë do të financohet nga Programi i CARDS 2003.

4.1.2 Policia dhe krimi i organizuar

Situata

Në 12 muajt e shkuar, policia ka pasur përparime në disa fusha, në veçanti për sa i përket zbatimit të ligjit për gradat dhe karrierën. Megjithatë, policia mbetet përgjithësisht e trajnuar dobët dhe ka mungesa në pajisjet bazë. Shumica e mjediseve të policisë janë të papërshtatshme për funksionin e saj dhe në kushte të këqija. Trajnimi i policisë, organizimi dhe funksionimi duhet të përmirësohen në mënyrë thelbësore, ashtu si dhe bashkëpunimi ndërmjet policisë dhe prokurorëve. Niveli i besimit ndërmjet këtyre organeve mbetet i ulët duke rrezikuar efektivitetin e luftës kundër krimit të organizuar, si trafiku i drogës dhe i armëve, trafiku i qenieve njerëzore, kontrabanda etj. Si rrjedhim, policia nuk është në gjendje të sigurojë në mënyrë të kënaqshme zbatimin e ligjit, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Besimi i investitorëve dhe i publikut në Shqipëri do të rritet vetëm në qoftë se policia do të tregojë profesionalizëm, sjellje etike, aftësi hetimore më të mira dhe një vullnet për të hetuar krimin e organizuar dhe kriminelët.

Organe të tjera kyç për zbatimin e ligjit, si për shembull qendra e informacionit financiar në Ministrinë e Financave, të cilat duhet të luajnë një rol drejtues në luftën kundër pastrimit të parave, janë mjaft larg përmbushjes së detyrave të tyre. Gjithashtu, për të trajtuar nevojat e tyre për mbështetje teknike dhe materiale, bashkëpunimi ndërmjet të gjitha organeve të përfshira në luftën kundër krimit ekonomik duhet të përmirësohet.

Projektet e identifikuara

5. MBËSHTETJE E PËRGJITHSHME LOGJISTIKE DHE TEKNIKE PËR POLICINË E SHTETIT (PSH)

Objektivi i përgjithshëm është të kontribuojë në çrrënjosjen e krimit të organizuar në Shqipëri, veçanërisht trafiqet e paligjshme (të drogave, armëve, automjeteve të vjedhura qenieve njerëzore), kontrabandës dhe aktiviteteve të pastrimit të parave.

Objektivi specifik është përmirësimi i aftësive të përgjithshme të PSH-së, duke përfshirë përmirësimin e gjendjes materiale për operacione ditore, forcimin e aftësive zbuluese, hetuese dhe denoncuese të Drejtorisë së Krimit të Organizuar dhe përmirësimi i aftësive operative të njësive rajonale antitrafik të PSH-së.

Aktivitetet kryesore do të jenë: (1) rehabilitimi i Akademisë së Policisë (faza II) dhe përgatitja e kurrikulimit të trajnimeve, (2) rehabilitimi i godinës së re të Policisë së Shtetit, (3) përmirësimi i infrastrukturës së qendrës së riparim-shërbimit dhe të ofiçinave të mirëmbajtjes së automjeteve të policisë, (4) sigurimi i pajisjeve speciale, trajnimeve dhe asistencës teknike për Drejtorinë e Krimit të Organizuar në PSH dhe (5) për njësitë rajonale antitrafik.

6. BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL NË LUFTËN KUNDËR PASTRIMIT TË PARAVE

Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti është të kontribuojë në çrrënjosjen e aktiviteteve të pastrimit të parave në Shqipëri.

Objektivat specifike janë përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregullator shqiptar, në mënyrë që të lejohen strategji më agresive kundër pastrimit të parave, përmirësimi i aftësive operative të organeve të ndryshme të ngarkuara në luftën kundër pastrimit të parave dhe forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional në luftën kundër krimit të organizuar.

Aktivitetet kryesore do të jenë: (1) ripërcaktimi i kompetencave, organizimi dhe metodat e punës të organeve të ndryshme të ngarkuara në luftën kundër krimit të organizuar, (2) ofrimi i trajnimit dhe asistencë teknike të nevojshme për to dhe (3) hartimi e zbatimi i udhëzimeve dhe procedurave të punës të përbashkëta, duke përfshirë zhvillimin e një sistemi të informacionit dhe komunikimit, me qëllim sigurimin e një progresi të shpejtë në hartimin dhe trajtimin e çështjeve.

7. Misioni i ndihmës policore të Komunitetit Europian për Shqipërinë (PAMECA)

Objektivi i përgjithshëm është të kontribuojë në zbatimin e ligjit në Shqipëri dhe në rikthimin e besimit të publikut për policinë.

Objektivat specifike janë përmirësimi i aftësive institucionale dhe operative të Policisë së Shtetit në luftën kundër krimit të organizuar dhe në ruajtjen e rendit publik, forcimi i bashkëpunimit ndërmjet Policisë së Shtetit dhe prokurorisë/gjykatave me qëllim sigurimin e trajtimit të duhur të çështjeve.

Aktivitetet do të përqendrohen në forcimin e kapaciteteve me komponentë, si këshillimi strategjik, trajnimet në fusha si organizimi, kuadri ligjor, zbatimi i strategjisë IT etj.Misioni i tanishëm PAMECA u krijua në fund të vitit 2002 për një periudhë dyvjeçare, e cila skadon në fund të vitit 2004. Ky model i një misioni lokal këshillimor ka qenë i përshtatshëm dhe i mirëpritur. Komisioni beson pra se kjo lloj mbështetje duhet të vazhdojë, në mënyrë që të shtohet në maksimum ndikimi i tij. Për këtë qëllim një thirrje e re për propozime do të shpallet për vazhdimin e PAMECA-s. Kjo thirrje do të shpallet për një projekt trevjeçar, ku viti i parë do të financohet nga ky plan veprimi (2004), ndërsa dy vitet e tjera do të varen nga disponueshmëria e fondeve për vitin 2005, të cilat nuk janë miratuar ende. Kjo mundësi do të shfrytëzohet, gjithashtu për të rregulluar mandatin e misionit, me qëllim forcimin e aspekteve operative të ndihmës dhe për të ofruar ekspertizë shtesë në fusha si antiterrorizmi.

4.1.3 Menaxhimi i integruar i kufijve (MIK)

Situata

Në shkurt 2003 Qeveria shqiptare miratoi strategjinë kombëtare për kontrollin e kufirit dhe menaxhimin e integruar të tij, i cili u hartua me ndihmën e komunitetit ndërkombëtar. Kjo strategji u miratua politikisht nga BE-ja në konferencën e Ohrit për menaxhimin e kufirit. Duke marrë parasysh përmasat e migracionit të paligjshëm dhe të krimit ndërkufitar në Shqipëri, vështirësitë që paraqesin karakteristikat fizike të kufirit të saj, burimet e pakta në dispozicion dhe gjendja e dobët e sistemit të saj të kontrollit të kufirit (mjedise të papërshtatshme ose joekzistente, mungesa e pajisjeve bazë-deri dhe telefonat-personel të pa trajnuar dhe të paguar keq, bashkëpunim i dobët ndërinstitucional etj.), zbatimi i efektshëm i strategjisë kombëtare ka nevojë për mbështetje të gjerë nga komuniteti ndërkombëtar.

Disa nga këto probleme, veçanërisht sigurimi i pajisjeve bazë, sigurimi i asistencës teknike me përvojë dhe përgatitja e sistemit të menaxhimit të kufirit detar janë duke u trajtuar tashmë me fonde të projekteve të mëparshme për MIK-në dhe doganat, si nga programet CARDS, ashtu dhe nga donatorë të tjerë. Këto veprimtari të ndihmës duhet të vazhdojnë për të arritur një ndikim efektiv.

PROJEKTET E E IDENTIFIKUARA

8. Mbështetje për Policinë Kufitare dhe administratën doganore në kufi

Objektivi i përgjithshëm është të kontribuojë për parandalimin e migracionit të paligjshëm dhe çrrënjosjen e krimit ndërkufitar, si dhe lehtësimi i lëvizjeve ndërkufitare të personave dhe mjeteve në *bona fides*.

Objektivat specifike janë përmirësimi i aktivitetit të Policisë Kufitare dhe të oficerëve të doganave, që veprojnë në kufi për parandalimin e migracionit të paligjshëm dhe çrrënjosjen e krimit ndërkufitar, si dhe për lehtësimin e lëvizjeve ndërkufitare për personat dhe mallrat në *bona fide*.

Aktivitetet kryesore do të jenë: (1) rehabilitimi i Policisë Kufitare dhe i mjediseve të doganave, (2) sigurimi i pajisjeve për kontrollin e kufirit, (3) trajnimet dhe (4) vendosja e një sistemi bashkëpunimi ndërinstitucional ndërmjet Policisë së Kufirit dhe administratës doganore në kufi.

9. Mbështetja për Ministrinë e Transportit dhe të Telekomunikacionit

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të kontribuojë për zhvillimin ekonomik në Shqipëri, integrimin rajonal dhe për përmirësimin e standardeve të sistemit rrugor në Shqipëri.

Objekti specifik i projektit është të forcojë kapacitetet e Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit.

Aktivitetet do të përqendrohen kryesisht në asistencën teknike për çështje si aftësitë koordinuese dhe menaxhuese të ministrisë, supervizioni i punimeve, standardizimi i parametrave të projektimeve, standardet e cilësisë së rrugëve dhe kuadri ligjor.

10. Mbështetje për Ministrinë e Transportit dhe të Telekomunikacionit dhe Autoritetin e Portit të Durrësit

Objektivi i përgjithshëm është të lehtësojë tregtinë dhe në të njëjtën kohë të krijojë kushtet e duhura për të siguruar një kontroll të efektshëm të kufirit në Portin e Durrësit.

Objektivi specifik është modernizimi i mjedisit të Portit.

Aktivitetet do të jenë: (1) supervizioni i ndërtimit të terminalit të trageteve dhe të projekteve për infrastrukturën e kantierit, (2) mbështetja për rritjen e kapaciteteve operative të portit, të

efiçencës dhe të sigurisë, (3) ofrimi i një infrastrukture dhe terminali modern për punë efiçente në port dhe për kontrollet e sigurisë e ato doganore, (4) ofrimi i një masterplani në përputhje me rritjen e trafikut të mallrave aktuale dhe të parashikuar për një periudhë afatmesme, (5) ofrimi i një plani për investime ekonomikisht të zbatueshme, (6) ofrimi i një plani të përditësuar për përdorimin e territorit, (7) mbështetjen e një strategjie investimesh gjithëpërfshirëse për portin dhe (8) përmirësimi i mjediseve pritëse të portit (për zbrazjen e serbatorëve të ndotur, pritjen e sarbatorëve të ujit të pastër etj.).

Nëse do të jetë e përshtatshme vlerësime të impaktit mjedisor mund të kryhen.

4.1.4 Azili dhe migrimi

Situata

Në vitin 2003 BE-ja përfundoi një marrëveshje ripranimi me Qeverinë shqiptare, që përfshin detyrimin për Shqipërinë për të ripranuar shtetas të vendeve të treta. Në të njëjtin vit, Qeveria shqiptare miratoi plani kombëtar i veprimit për azilin të përgatitur në bashkëpunim me UNHCR-në dhe filloi përgatitjen e një strategjie kombëtare dhe planveprimi për migracionin me ndihmën e IOM-it dhe financimin e programit CARDS 2001[3]

Qeveria aktualisht menaxhon qendrat e pritjes të Linzës dhe Babrrusë, të cilat merren përkatësisht me imigrantët e paligjshëm azilkërkuesit/refugjatët me mbështetjen e IOM-it dhe UNHCR-së, por ajo nuk zotëron ende aftësitë institucionale për të pasur një përgjegjësi të pavarur. Duke marrë parasysh nevojën për zbatimin e strategjisë kombëtare të migracionit dhe për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshja e ripranimit, kapacitetet shqiptare duhet të zhvillohen dhe qendrat pritëse të forcohen. Gjithashtu duhet të krijohet një qendër pritëse e mbyllur për shtetasit e riatdhesuar në transit të vendeve të treta.

Projektet e indentifikuara

11. Mbështetje për zbatimin e Marrëveshjes së Ripranimit dhe të strategjisë kombëtare për migracionin

Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti është të mbështesë Qeverinë shqiptare në procesin e krijimit dhe zbatimit të një sistemi ripranimi, migracioni dhe azili në përputhje me standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare.

Objektivi specifik i projektit është krijimi i mjedisit dhe mekanizmave të përshtatshëm që janë të nevojshëm për zbatimin e Marrëveshjes së Ripranimit me KE-në dhe zbatimin e strategjisë kombëtare për migracionin dhe të planit të veprimit. Forcimi i kapaciteteve pritëse të Shqipërisë për të mundësuar përballimin e flukseve të imigrantëve të parregullt dhe të azilkërkuesve/refugjatëve: përmirësimi i kushteve për migrantët, viktimat e trafikut dhe azilkërkuesit/refugjatët dhe ndihmë për fëmijët dhe gratë e trafikuara.

Aktivitetet kryesore do të jenë: (1) mbështetja e zbatimit të Marrëveshjes së Ripranimit me KE-në, (2) zbatimi i strategjisë kombëtare/planit të veprimit për migracionin, (3) forcimi i qendrës pritëse në Linzë dhe (4) Babrru.

4.2 Fusha prioritare nr.2- Forcimi i kapaciteteve administrative

Situata

Qeveria e tanishme shqiptare ka trashëguar një shërbim civil mjaft të pafavorshëm. Pagat janë mjaft të ulëta dhe në përgjithësi të pamjaftueshme për të mbajtur një familje. Kjo vështirëson rekrutimin, motivimin dhe mbajtjen e nëpunësve të mirë. Pavarësisht përpjekjeve të fundit për reformim, procedurat e rekrutimit, emërimit dhe rritjes në detyrë nuk janë transparente. Kështu korrupsioni dhe nepotizmi përfaqësojnë ende probleme, ideja se shërbimi civil ekziston për t'i shërbyer publikut, si dhe shtetit apo që shërbimi civil duhet të jetë i pavarur nga partitë politike nuk është rrënjosur ende. Shërbimi civil duhet të jetë më i madh, dhe në çdo rast nëpunësit civil kanë nevojë për trajnime, si të përgjithshme ashtu edhe të specializura. Zyrat janë në përgjithësi shumë afër nivelit bazë dhe janë përgjithësisht të pajisura keq. Shqipëria ka nevojë për forcim kapacitetesh institucionale në nivele të ndryshme të qeverisë qendrore, rajonale vendore. Ndryshimi evolutiv i kulturës administrative duhet të kryhet në një mënyrë të qëndrushme.

DS-ja rekomandon që mbështetja për Shqipërinë në fushën e forcimit të kapaciteteve

[3] Ky detyrim do të hyjë në fuqi dy vjet pas hyrjes në fuqi të vetë Marrëveshjes.

administrative duhet t'i jepet administratës publike në përgjithësi, si dhe në fusha specifike dhe interes për procesin e stabilizim-asocimit, si prokurim publik, doganat, tatimet dhe statistikat.

Edhe pse këto të fundit janë të mbuluara në mënyrë të mjaftueshme nga programet në zbatim të vitit 2002 dhe 2003, Qeveria nuk i ka dhënë rëndësinë e duhur efiçencë së shpenzimeve. Kjo është një nga arsyet pse është propozuar një mbështetje e re për Kontrollin e Lartë të Shtetit, i cili është mbështetur edhe nga Programi i vitit 1999, me qëllim krijimin e bazave të qëndrueshme për këtë Institucion. Nga ana tjetër, mbështetja për administratën publike në përgjithësi, edhe pse aktualisht në zbatim, duhet të përmirësohet. Ky program veprimi do të vazhdojë pra të mbështesë Departamentin e Administratës Publike dhe Institutin e Trajnimitë Administratës Publike, duke pasur mundësinë për të trajtuar, për herë të parë, çështjen e licensimit e cila ka ndikim të rëndësishëm si për luftën kundër korrupsionit, ashtu edhe për marrëdhëniet ndërmjet administratës dhe publikut në përgjithësi.

Projektet e indentifikuara

12. Reforma në administratën publike

Objektivi i përgjithshëm i projektit është reforma e administratës publike shqiptare, që ajo të bëhet më e efektshme, efiçente dhe trasparente.

Objektivat specifike të projektit janë përmirësimi i mundësisë së përfitimit, ofrimit dhe cilësisë së shërbimeve të Qeverisë, përmirësimi i aftësive trajnuese të Institutit të Trajnimit të Administratës Publike dhe përmirësimi i qarkullimit ndërinstitucional të informacionit.

Aktivitetet do të përfshijnë trajnimin, asistencën teknike, rehabilitimin e pajisjen, si dhe ofrimin e pajisjeve IT.

13. Zhvillimi i auditimit të jashtëm

Objektivi i përgjithshëm i projektit është rritja e efiçencës së shpenzimeve publike dhe pakësimi (reduktimi) i korrupsionit.

Objektivi i përgjithshëm i projektit është forcimi i aftësive të Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH) për t'i ofruar Kuvendit të Shqipërisë, të interesuarve të tjerë publikë dhe publikut në përgjithësi informacion cilësor mbi veprimtarinë financiare e të sektorit publik shqiptar.

Aktivitetet do të përfshijnë ofrimin e asistencës teknike të duhur, trajnime dhe pajisjeve sipas standardeve europiane, menaxhimin cilësor, sigurimin e cilësisë, kuadrin ligjor, planifikimin, kapacitetet menaxhuese (duke përfshirë burimet njerëzore) dhe organizimin strukturor të KLSH-së, si dhe vendosja e forcimi i marrëdhënieve të KLSH-së sektorë të tjerë të sistemit të menaxhimit, kontrollit dhe auditimit financiar.

4.3 Fusha prioritare nr.3- Zhvillimi ekonomik dhe social.

Situata

Megjithë rritjen e lehtë kohët e fundit të PBB-së për frymë, Shqipëria mbetet një vend i karakterizuar nga varfëria e përhapur, veçanërisht në zonat rurale, me një pjesë të konsiderueshme të popullsisë që jeton me më pak se 2 € në ditë. Shqipëria ka një përqindje të lartë të rritjes së popullsisë për shkak të përqindjes së lindjeve (më e larta në Europë). Edhe pse dërgimi i parave nga emigrantët ka ndihmuar në mbështetjen e ekonomisë shqiptare, ana negative qëndron në largimin e punëtorëve të zotë e të edukuar (edhe pse emigrimi është tashmë në rënie). Gati gjysma e popullsisë është nga 5-29 vjeç, gjë që krijon shumë trysni mbi kërkesën për shkollim dhe punësim. Migrimi nga zonat rurale në zonat urbane të Shqipërisë vazhdon, me një të tretën e elektoratit që banon tashmë në zonën e Tiranës.

Ky urbanizim i menjëhershëm ka sjellë vështirësi të konsiderueshme për sa i përket përjashtimit social dhe duket se nuk do të reflektohet ashtu siç duhet në planin e investimeve sociale. Shpenzimet për shkollimin, si përqindje e Buxhetit të Shtetit, nuk janë duke u rritur me shpejtësinë e duhur për të kënaqur kërkesën në rritje. Cilësia e shkollimit nuk po përmirësohet, ndërsa arsimi dhe formimi profesional nuk luan më një rol të ndjeshëm. Oferta paralele private është duke tërhequr studentët nga sektori publik, veçanërisht në Tiranë, por mbetet mjaft e parregulluar. Sistemi shëndetësor është duke vuajtuar nga trashëgimia e së kaluarës me mungesë investimesh, pagesa e ulët e mjekëve dhe infermierëve dhe nga spitale e klinika të pajisura keq e të rrënuara.

Në bazë të rekomandimeve të DS-së, këtë vit programi synon të përmirësojë kushtet e jetesës në zonat më të varfëra e rurale, duke kryer investime në infrastrukturën lokale, kjo edhe si

një përpjekje për të shmangur migrimin rural drej zonës urbane. Programi vazhdon gjithashtu me mbështetjen e ofruar edhe nga programet e mëparshme CARDS për sektorin e arsimit dhe formimit profesional dhe sektorin universitar. Në të dyja rastet përqendrimi do të jetë në reformën institucionale.

Projektet e indentifikuara

14. Programi i zhvillimit të komuniteteve lokale

Objektivi i përgjithshëm është përmirësimi i kushteve të jetesës në popullata të caktuara rurale të Shqipërisë. Është parashikuar që pjesës verilindore të Shqipërisë t'i kushtohet një trajtim preferencial, në përputhje me DS-në.

Objektivat specifike të projektit janë mbështetja për zhvillimin e strategjive koherente rajonale duke synuar nxitjen e punësimit, rehabilitimin ose ndërtimin e infrastrukturës lokale dhe sigurimi i qëndrueshmërisë së investimeve publike ekzistuese apo të ardhshme.

Aktivitetet do të përqendrohen në forcimin e kapaciteteve në nivelin e qeverisjes vendore, studime rajonale, punime për qëllime civile përgatitja e projektzbatimeve dhe supervizioni i punimeve. Krijimi i një fondi të mirëmbajtjes si nënprojekti dhe mbledhja e kontributit prej 10% të kostos totale të një projekti nga organet vendore.

15. Krijimi i një sistemi të decentralizuar të AFP-së dhe të të mësuarit afatgjatë

Objektivi i përgjithshëm i projektit është ofrimi i një sistemi të AFP-së të vetëm dhe cilësor që të jetë në gjendje të kontribuojë në stabilitetin ekonomik dhe social të rajonit.

Objektivat specifike janë të decentralizojë sistemin e AFP-së, të zhvillojë një sistem të ri të sigurimit të cilësisë dhe të forcojë reformën e AFC-së.

Aktivitetet si këshillim teknik, pajisje dhe punime do të ofrohen për këtë qëllim.

16. Tempus

Objektivi i përgjithshëm i programit është nxitja e sistemit të arsimit të lartë (në përputhje me Deklaratat e Bolonjës), i cili, nga ana tij, pritet të pakësojë "rrjedhjen e trurit" dhe të kontribuojë në zhvillimin e ekspertizës e lokale të nevojshme për përparimin ekonomik dhe social.

Objektivat specifike janë të mbështesë modernizimin e metodologjisë dhe të përmbajtjes së kurseve të arsimit të lartë dhe të forcojë bashkëpunimin rajonal dhe ligjet ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë në Europën Juglindore.

Për sa i përket aktiviteteve, programi vepron nëpërmjet projekteve të përbashkëta europiane (PPE), masave strukturore dhe plotësuese (MSP) dhe granteve të lëvizshmërisë individuale (GLI). Të gjitha vendet e përfshira në këtë PV po punojnë për riorganizimin e sistemit arsimor, në veçanti të arsimit të lartë dhe të arsimit e formimit profesional.

4.4 Fusha prioritare nr.4- Mjedisi dhe burimet natyrore

Situata

Institucioni qendror është Ministria e Mjedisit, por pesë institucionet kombëtare aktualisht kompetente për çështjet mjedisore vazhdojnë të kenë probleme për koordinimin dhe monitorimin. Plani i veprimit kombëtar shqiptar për mjedisin është (PVKSHM) përfshin një formim gradual me acquis communitaire. Standardet metodologjike për mbledhjen, menaxhimin dhe analizën shkencore e të dhënave nuk ekzistojnë dhe nuk është krijuar asnjë bazë elektronike të dhënash qendrore. Vendi ka mungesa në aftësitë monitoruese dhe për të vepruar efektivisht në lidhje me të dhënat mjedisore, të cilat janë thelbësore për një vendimmarrje të shëndoshë. Sistemi i monitorimit dhe i inspektimit duhet të lehtësohet dhe zbatimi i ligjeve mjedisore duhet të forcohet.

Burimet ujore në Shqipëri janë të rrezikuara nga ndotja e derdhjeve të ujërave të zeza urbane dhe ujërave industriale. Ndotësit janë indentifikuar në industritë e përpunimit të çimentos, lëkurave, qeramikës, tekstileve, minierave, karburanteve e gazit dhe lëndës së drurit. Monitorimi i ujit të pijshëm kryhet rregullisht, por nuk bëhet për pesticidet, metalet e rënda, mbetjet e përhershme organike dhe hidrokaburet. Zonat urbane të Shqipërisë kanë një nivel të lartë të ndotjes së ajrit për shkak të zhvillimit të pakontrolluar.

Mungesa e një planifikimi të përshtatshëm rajonal dhe urban parandalon investimet fizike të kënaqshme. Sasia e madhe e ndërtimeve të paligjshme vështirëson planet e ardhshme të zhvillimit dhe shkakton probleme mjedisore. Mungesa e planifikimit urban ka gjithashtu një ndikim të keq social.

Projektet që do të financohen nga fusha prioritare e mjedisit dhe burimeve natyrore janë vlerësuar për të siguruar përputhjen e tyre me PISH-in.

Projektet e identifikuara

17. Sistemet e menaxhimit të mbetjeve të rrezikshme (Faza II-ndërtimi i depozitës)

Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti është përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve të rrezikshme në Shqipëri dhe kështu të pakësohen ndikimet negative në shëndet të lidhur me "zonat e nxehta" të identifikuara të mbetjeve të rrezikshme dhe për të përmirësuar cilësinë e mjedisit.

Objektivi specifik i këtij projekti është ndërtimi i një depozite të sigurt të mbetjeve të rrezikshme, duke mbuluar kështu fazën e dytë të projektit të përgjithshëm për mbetjet e rrezikshme.

Aktivitetet do të përfshijnë: (1) supervizimin dhe punime të fazës II të punimeve për depozitën, (2) supervizimi i fazës II të sistemit të menaxhimit të depozitës dhe (3) ndërtimi i depozitës duke ndjekur projektzbatimin e fazës I.

18. Forcimi i sistemit të monitorimit mjedisor

Objektivi i përgjithshëm i projektit është përmirësimi i cilësisë së mjedisit.

Objektivi specifik i projektit është ritja e aftësisë së monitorimit, analizimit dhe hartimit të masave të përshtatshme për cilësinë e mjedisit në vend dhe për të mundësuar Shqipërinë në përputhje me standardet e Agjencisë Europiane të Mjedisit (AEM).

Aktivitetet kryesore do të ofrojnë gjithë ekspertizën, trajnimin dhe pajisjet e nevojshme për të përgatitur në një fazë të parë programin kombëtar për monitorimin e cilësisë mjedisore (PKMCM) dhe, në një fazë të dytë, zbatimin e tij.

19. Zhvillimi i qëndrueshëm dhe i integruar i rajonit Tiranë-Durrës

Objektivi i përgjithshëm i projektit është nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm dhe të integraur të rajonit Tiranë-Durrës.

Objektivi specifik është ofrimi i primeve dhe udhëzimeve për një menaxhim të shëndoshë të përdorimit të tokës dhe për forcimin e aftësive planifikuese të qeverisjes vendore për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm në përputhje me praktikat e mbrojtjes mjedisore.

Aktivitetet do të përfshijnë analizën e territorit të hartimit të një masterplani, trajnimin në vendin e punës dhe një studim fizibiliteti ekonomik dhe financiar.

4.5 Fusha prioritare nr.5-Stabilizimi demokratik

Situata

Edhe pse në krahasim me vitet 1997/1998 Shqipëria është disi më e stabilizuar, konsolidimi i një kulture demokratike më konsensuale mbetet i nevojshëm me qëllim realizimin e disa reformave të vështira.

Zgjedhjet e vitit 2001 dhe zgjedhjet vendore të vitit 2003 u pasuan nga periudha të gjata grindjesh në lidhje me rezultatin, për shkak të përhapjes së gjerë të polemikave në lidhje me listën e zgjedhës. Padyshim zhvillimi i zgjedhjeve vendore të muajit tetor 2003 nuk kënaqi shpresat e Komisionit.

Më në përgjithësi, respektimi dhe zbatimi i shtetit ligjor në Shqipëri mbetet i pamjaftueshëm. Të paktën pjesërisht përgjegjësia për këtë gjendje mund t'i ngarkohet gjendjes së varfër të zhvillimit të shoqërisë civile.

Si dokumenti strategjik, ashtu edhe PISH-i përqendrohen në rolin e kësaj të fundit në stabilizimin demokratik dhe, duke marrë parasysh dobësitë e këtij sektori në Shqipëri, në rëndësinë e mbështetjes së sektorit të shoqërisë civile/OJF-ve në vend. Megjithatë, Komisioni mendon se sektori i OJF-ve në Shqipëri mund të thithë mbështetjen financiare vetëm në mënyrë graduale; ka ende 1000 000 € për t'u alokuar nga programi i CARDS 2002 për shoqërinë civile. Kjo shumë do t'i shpërndahet organizatave të shoqërisë civile që veprojnë në fushat e përcaktuara në PISH-demokratizimi, të drejtat civile dhe të njeriut, pakicat, riintegrimi i viktimave të trafikut etj.

Pra, pogrami CARDS 2004 përqendrohet në procesin zgjedhor. Ai tenton të përfundojë reformën e regjistrit të gjendjes civile, duke përdorur fondet e vitit 2003, kështu që një listë zgjedhësish e saktë të mund të përgatitet për zgjedhjet e vitit 2005 dhe më tej.

Përpjekjet e identifikuara

20. Mbështetje për sistemin e regjistrit të gjendjes civile

Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti është të mbështesë reformën në administratën publike dhe stabilizimin demokratik të Shqipërisë.

Objekti specifik është modernizimi i plotë i sistemit shqiptar të regjistrit të gjendjes civile.

Projekti ofron kushtet e nevojshme për zhvillimin e zgjedhjeve transparente dhe kështu që ka një ndikim të qartë në forcimin e demokracisë në Shqipëri. Gjithashtu, përderisa në momentin e përfundimit të këtij projekti Qeveria shqiptare duhet të jetë në gjendje të lëshojë kartat e identitetit për shtetasit e saj, projekti mund të ndihmojë edhe në forcimin e shtetit ligjor (përderisa, në veçanti, kartat identitetit mund të luajnë një rol në luftën kundër krimit të organizuar dhe mashtrimeve të çdo lloji).

Aktivitetet do të konsistojnë në asistencë teknike, trajnime (dhe hedhje të dhënash) dhe ofrim pajisjesh.

5. Ndihmë plotësuese e KE-së jashtë këtij plani veprimi

Plani i veprimit për Shqipërinë plotësohet nga dhe do të koordinohet me programet vjetore rajonale CARDS.

Do të merren parasysh projektet INTERREG, përkatësisht, ndërmjet Shqipërisë e Italisë dhe Shqipërisë e Greqisë, në momentin e identifikimit dhe zbatimit të një numri projektesh të këtij plani veprimi. Kjo do të aplikohet në mënyrë të veçantë për aktivitetet në fushën e drejtësisë dhe punëve të brendshme, për shembull prioritetet për vitin 2002 të programit INTERREG prej 126 000 000 € ndërmjet prefekturave greke të Follorinës, Kosturit Janinës, Thesprotisë e Korfuzit dhe retheve shqiptare të Gjirokastrës, Përmetit, Korçës, Devollit, Vlorës, përfshijnë e zhvillimin ekonomik punësimin dhe infrastrukturën ndërkufitare ku prioriteti i fundit është një fushë me interes të veçantë në këtë plan veprimi. Ky i fundit duhet të koordinohet gjithashtu me projektet INERREG të rajonit të Pulias edhe këto të vitit 2002 dhe me një shumë financiare prej 72 800 000 € dhe i cili përqendrohet, ndërmjet të tjerash, në fusha si transporti, komunikacioni, siguria e mjedisi zhvillimi ekonomik e punësimi. Plotësueshmëria e mundshme ndërmjet programit të veprimit CARDS dhe INTERREG duhet të shqyrtohet me kujdes në momentin e detajimit të projekteve përkatëse CARDS.

Gjithashtu në tremujorin e dytë të vitit 2004 pritet një vendim i Këshillit me propozim të Komisionit që synon ofrimin e një ndihme makrofinanciare për Shqipërinë. Kjo ndihmë, që kap shumën e 25 000 000 €, do të përfshijë një pjesë grant prej 16 000 000 € dhe një pjesë kredie prej 9 000 000 €.

Edhe pse nuk parashikohet më ndihmë për Shqipërinë nga NEDDNJ-ja sasi të vogla fondesh nga zërat buxhetorë sektorialë (fondi për bashkëfinancimin e OJF-ve, programi LIFE, menaxhimi i azilit në vendet e treta etj.) do të vazhdojnë të jenë të disponueshme nëpërmjet thirrjeve për propozime. Shqipëria përfiton gjithashtu edhe nga programi i 6$^{të}$ kuadër i KE-së.

6. KOORDINIMI ME DONATORË TË TJERË

Meqenëse Komisioni ka hequr dorë nga financimi i infrastrukturave ekonomike me përfundimin e programit të vjetër PHARE, Shqipërisë i është dashur të gjejë investime të tilla nga burime të tjera. Italia dhe Greqia ofrojnë investime domethënëse në infrastrukturën kombëtare të transportit (kryesisht, atë rrugore), ndërsa Italia dhe Banka Botërore kanë kryer investime jetike në sektorin e energjisë. Disa donatorë të tjerë, të tillë si Gjermania dhe Austria, kanë ofruar asistencë thelbësore në sektorë të tjerë të infrastukturës, të tilla si uji dhe kanalizimet. Roli i BEI-it dhe BERZH-it në dhënien e kredive për infrastrukturën dhe i BERZH-it në ofrimin e kapitaleve ka qenë domethënës.

Koordinimi i donatorëve të Shqipërisë nuk ka qenë shembullor në dy vitet e fundit. Donatorët kanë qenë dhënë të irrituar për mungesën e dukshme të interesit të Qeverisë për integrimin e programeve të ndryshme të donatorëve në një program koherent ekonomiko shoqëror të pasqyruar në PBA. Megjithatë, donatorët kanë punuar për disa kohë për krijimin e mekanizmave për sigurimin e koordinimit ndërmjet tyre. Projektet në këtë drejtim janë duke u kthyer nga të gjithë. Një dialog në lidhje me çështjet e koordinimit është hapur me Qeverinë nëpërmjet sekretariatit teknik të donatorëve (KE-ja, PKBZH-ja, Banka Botërore dhe OSBE-ja, ku Mbretëria e Bashkuar, Komisioni Europian, KBZH-ja dhe Banka Botërore ofrojnë mbështetje të koordinuara për funksionimin e menaxhimit ekonomik të Qeverisë.

7. Zbatimi i programit

7.1 Afati për firmosjen e Marrëveshjes Financiare

Marrëveshja financiare duhet të firmoset, e shumta, brenda 31 dhjetorit të vitit që vjen pas vitit në të cilin angazhimi i përgjithshëm financiar përkatës është miratuar. Në rast të kundërt, fondet e caktuara do të anulohen.

7.2 Periudha e veprimit

a) Periudha e zbatimit të Marrëveshjes Financiare fillon në hyrjen në fuqi të Marrëveshjes financiare dhe përfundon më 31.12.2011.

b) Kjo periudhë veprimi ndahet në dy faza të veçanta:

i) Zbatimi operativ i aktiviteteve kryesore. Kjo fazë fillon me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes Financiare dhe përfundon në datën 31.12.2009.

ii) Faza e mbylljes gjatë së cilës do të kryhen kontrollet financiare dhe vlerësimet e kontratave për zbatimin e Marrëveshjes Financiare. Kjo fazë fillon me përfundimin e fazës së zbatimit operativ dhe përfundon në fund të periudhës së veprimit.

c) Shpenzimet e kryera për aktivitetet kryesore nuk janë të pranueshme për financimin e Komunitetit veçse nëse janë kryer gjatë fazës së zbatimit operativ. Shpenzimet e nevojshme për kontrollet financiare përfundimtare, vlerësimin, si dhe aktivitetet e mbylljes janë të pranueshme deri në fund të fazës së mbylljes.

d) Çdo fond i mbetur nga kontributi i Komunitetit do të anulohet automatikisht gjatë muajit, pas përfundimit të periudhës së veprimit.

e) Një kalendar indikativ për (tenderimin dhe) lidhjen e kontratave është bashkëngjitur me shtojcën A në fund të këtij plani veprimi. Ky kalendar është vetëm indikativ përderisa tenderimi nuk mund të fillojë, derisa:

i) së pari, çdo aktivitet i nevojshëm për zbatimin e aktiviteteve të financuara nga programi i veprimit 2004, por të financuar nga programet e mëparshme të veprimit të mos ndodhet mjaftueshmërisht i përparuar në terren (kjo supozohet të jetë e vërtetë në këtë fazë);

ii) së dyti, Qeveria shqiptare të miratojë Marrëveshjen Financiare që do të rregullojë këtë plan veprimi deri në fund të vitit 2004;

iii) së treti, kushtëzimet për objektet, aty ku është e nevojshme, të përmbushen; dhe

iv) së katërti, projektet të jenë detajuar plotësisht.

7.3 Procedurat për dhënien e kontratave dhe të subvencioneve

Të gjitha projektet duhet të zbatohen në përputhje me parimet e BE-së për konkurrencën (duke përfshirë ndihmën shkencore). Të gjitha kontratat zbatuese të Marrëveshjes Financiare duhet të jepen duke përdorur procedura dhe dokumete standarde të Komisionit mbi zbatimin e operacioneve të jashtme, të cilat janë në fuqi në kohën kur fillohen procedurat.

7.4 Kontrata zbatuese të Marrëveshjes

a) Kontrata zbatuese të Marrëveshjes Financiare duhet të firmosen nga të dyja palët brenda tre vitesh nga miratimi nga ana e Komisionit të angazhimit financiar. Ky afat nuk mund të shtyhet. Në këtë datë të gjitha fondet e pakontraktuara do të anulohen.

b) Çdo kontratë që nuk ka sjellë asnjë pagesë brenda tre vitesh nga firmosja e saj, do të përfundohet automatikisht dhe fondet do të anulohen.

7.5 Monitorimi, vlerësimi dhe auditimet

Gjatë zbatimit do të kryhen monitorimet e planifikuara e të rregullta të duhura në formën e raporteve të rregullta. Do të kryhet gjithashtu edhe vlerësimi gjatë zbatimit dhe në përfundim të programit, si dhe auditimi i programit. Pika 7.4 (a) nuk do të aplikohet për auditimet dhe vlerësimet e kontratave, të cilat mund të firmosen më vonë.

8. Kostot dhe financimi

Programi do të financohet nëpërmjet një granti të propozuar nga Komuniteti prej 58 500 000 €, të ndara si më poshtë vijon, ndërmjet sektorëve prioritarë dhe nënsektorëve:

| Sektori/nënsektori | Buxheti (milionë €) |
|---|---|
| Drejtësia dhe punët e brendshme<br>Reforma në drejtësi<br>Policia dhe krimi i organizuar<br>Menaxhimi i integruar i kufirit<br>Menaxhimi i azilit dhe imigrimit | 34.0 |
| Forcimi i kapaciteteve administrative<br>Zhvillimi ekonomik dhe shoqëror | 3.0<br>12.0 |
| Zhvillimi i komuniteteve lokale<br>Arsimi | |
| Mjedisi dhe burimet natyrore | 7.0 |
| Stabilizimi demokratik | 2.5 |
| TOTALI | 58.5 |

9. Angazhimi i Qeverisë dhe kushtëzimet

Ndihma do të afrohet me kusht që të ekzistojnë elementet e nevojshme për vazhdimin e bashkëpunimit nëpërmjet ndihmës, në veçanti respektimi i parimeve demokratike dhe i të drejtave të njeriut, si dhe i detyrimeve të Shqipërisë të përcaktuara gjatë procesit të stabilizim-asocimit.

Gjithashtu Qeveria shqiptare pritet, në veçanti, që të japë prova për angazhimin e saj në luftën kundër krimit të organizuar, kontrabandës dhe trafiqeve të të gjitha llojeve, duke u përqendruar sidomos në portet dhe aeroportet.

Së fundmi, zbatimi i projekteve të veçanta do të fillojë vetëm ku kushtet e bashkëngjitura atyre (nëse ka) do të përmbushen.

Shtojca A: Kalendari indikativ për tendrimin dhe kontraktimin

| Projekti/ komponenti | Procedura indikative tenderuese | Data indikative për shpalljen e tendrit | Data indikative për firmosjen e kontratës |
|---|---|---|---|
| 01 Rehabilitimi i institucioneve në varësi të Ministrisë së Drejtësisë | | | |
| Burgu i Korçës (ndërtimi) | Punime | T3 2005 | T1 2006 |
| Burgu i Korçës (mobilimi/pajisjet) | Pajisje | T3 2006 | T1 2007 |
| Trajnimi i oficerëve të burgjeve | Grant | T2 2005 | T4 2005 |
| Qendra e Publikimeve Zyrtare (rehabilitimi) | Punime | T1 2006 | T3 2006 |
| Qendra e Publikimeve Zyrtare (pajisjet) | Pjisje | T2 2006 | T3 2007 |
| 02 Forcimi i kapaciteteve për hetimin dhe ndëshkimin e krimit të organizuar | | | |
| Hetimi/ndjekja penale (asist.teknike dhe trajnim) | Grant | T4 2005 | T2 2006 |
| Pajisje për Gjykatën e Krimeve të Rënda | Pajisje | T4 2005 | T2 2006 |
| 03 Mbështetje për Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe Inspektoratin e tij | | | |
| Asistencë teknike dhe trajnime | Grant | T2 2005 | T4 2005 |
| Mobilim dhe pajisje | Pajisje | T2 2005 | T4 2005 |
| 04 Krijimi i një sistemi të drejtësisë për çështjet e tregtare dhe të miturit | | | |
| Sistemi i drejtësisë për të miturit (asist tek & trajn.) | Grant | T3 2005 | T1 2006 |
| Qendra e burgimit për të miturit (rehabilitim/ndërtim) | Punime | T4 2005 | T2 2006 |
| Qendra e burgimit për të miturit (mobilim/pajisje) | Pajisje | T1 2007 | T3 2007 |
| Sistemi i drejtësisë në çështjet tregtare (asistencë,trajnim) | Grant | T3 2005 | T1 2006 |

| Projekti/ komponenti | Procedura indikative tenderuese | Data indikative për shpalljen e tendrit | Data indikative për firmosjen e kontratës |
|---|---|---|---|
| Mbështetje e përgjithshme logjistike dhe teknike për Policinë e Shtetit Shqiptar | | | |
| Akademia e Policisë, garazhdi qendror dhe oficina e mirëmbajtjes (rehabilitim) | Punime | T4 2005 | T2 2006 |
| Akademia e Policisë (asistencë teknike) | Grant | T4 2005 | T2 2006 |
| Garazhdi qendror dhe oficina e mirëmbajtjes (mobilim/pajisje) | Pajisje | T4 2006 | T1 2007 |
| Godina e re PSH-së (rehabilitim) | Punime | T1 2005 | T3 2005 |
| Godina e re PSH-së dhe e Drejtorisë Rajonale Antitrafik (mobilimi/pajisjet) | Pajisje | T2 2006 | T4 2006 |
| Drejtoria e krimit të organizuar (asist. tekn&train) | Grant | T2 2006 | T4 2006 |
| Drejtoria e krimit të organizuar (pajisje) | Shmangie | T2 2006 | T4 2006 |
| Njësitë rajonale antitrafik (asis. tekn. dhe trajnime) | Grant | T2 2006 | T4 2006 |
| 06 Bashkëpunimi ndërinstitucional në luftën kundër pastrimit të parave | | | |
| Lufta kundër pastrimit të parave (asist. tekn&trajn) | Grant | T2 2005 | T4 2005 |
| Mjediset e NJIF (rehabilitim/ndërtimi) | Punime | T4 2005 | T2 2006 |
| Sisteme IT (projektimi) | Shërbime | T4 2005 | T2 2006 |
| Sisteme IT (pajisjet) | Pajisje | T1 2007 | T3 2007 |
| 07 Misioni i ndihmës policore të Komunitetit Europian (PAMECA-bis) | | | |
| PAMECA (asitenca teknike dhe trainime) | Grant | T3 2004 | T4 2004 |
| 08 Mbështetja e Policisë Kufitare dhe autoritetet doganore në kufishqipëri. | | | |
| Pikat e kalimit të kufirit (rehabilitimit) | Punime | T2 2006 | T4 2006 |
| Trajnime dhe asistencë teknike | Për t'u vendosur | Për t'u vendosur | Për t'u vendosur |
| Pajisje për kontroll kufitar | Pajisje | T2 2006 | T4 2006 |
| 09 Ndihmë për Ministrinë e Transportit dhe të Telekomunikacionit | | | |
| Asitencë teknike për PIU-n. | Shërbime | T1 2006 | T3 2006 |
| Supervizioni i ndërtimit të rrugëve Levan-Tepelenë | Shërbime | T1 2006 | T3 2006 |
| Studim për projektimin dhe standardet e ndërtimit të rrugëve | Shërbime | T3 2005 | T1 2006 |
| 10 Mbështetje për Autoritetin Portual të Durrësit | | | |
| Supervizimi i terminalit të tragetëve | Shërbime | T4 2005 | T2 2006 |
| Masterplani | Shërbime | T3 2005 | T1 2006 |
| 11 Mbështetje për zbatimin e marrëveshjes së ripranimit dhe të strategjisë kombëtare për migrimin | | | |
| Qendra për shtetasit e vendeve të treta të ripranuar dhe qendra për azilkërkuesit | Punime | T4 2005 | T2 2006 |

| Projekti/ i komponenti | Procedura indikative tenderuese | Data indikative për shpalljen e tenderit | Data indikative për firmosjen e kontratës |
|---|---|---|---|
| Qendra për shtetasit e vendeve të treta të ripranuar<br>Qendrat për viktimat e trafikut (mobilimi/pajisjet) | Pajisjet | T1 2007 | T3 2007 |
| Ripranimi, azili dhe viktimat e trafikut (asistencë teknike edhe trainime) | Grant | T3 2005 | T1 2006 |
| 12 Reforma në administratën publike | | | |
| AT për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike | Shërbime/grant | T4 2005 | T2 2006 |
| Asistencë teknike për sistemin e trajnimit të Qeverisë shqiptare | Shërbime/grant | T1 2006 | T3 2006 |
| Pajisje IT për rritjen e komunikimit | Pajisje | T1 2007 | T3 2007 |
| Punime për rehabilitimin e Institutit të Trajnimit | Punime | T1 2006 | T3 2006 |
| 13 Zhvillimi i auditimit të jashtëm | | | |
| Asistencë teknike për auditimin, çështjet juridike, planifikimi, trajnimi, burimet njerëzore , teknologjinë e komunikimit dhe të informacionit dhe përgjegjësinë financiare | Shërbime/grant | T2 2005 | T4 2005 |
| 14 Programi për zhvillimin e komuniteteve lokale | | | |
| Programi i punës nr.1 | Punime | T4 2005 | T2 2006 |
| Programi i punës nr.2 | Punime | T2 2006 | T4 2006 |
| 15 Krijimi i një sistemi të decentralizuar të AFP-së dhe të të mësuarit afatgjatë | | | |
| Asistencë teknike për çështjet e decentralizimit, trajnimin në nivel sistemi, trajnimin e menaxherëve të qendrave dhe mësuesve, përgatitja e librave mësimore dhe të punës | Shërbime | T1 2006 | T3 2006 |
| Skemë lokale granti | Grant | T1 2007 | T3 2007 |
| Punime për rehabilitimin e qendrave të AFP-së | Punime | T1 2007 | T3 2007 |
| Pajisje për shkollat/qendrat e AFP-së | Pajisje | T1 2007 | T3 2007 |
| 16 Tempus | | | |
| Projekte të përbashkëta | | T3 2004 | T4 2005 |
| Masa strukturore | | T3 2004 | T2/05-T1/06 |
| Grante për vizitat individuale | Thirrje për Propozime | T3 2004 | T2-3/05-T1/06 |
| 17. Menaxhimi i sistemit të mbetjeve të rrezikshme (faza II-ndërtimi i depozitës) | | | |
| Ndërtimi i depozitës së sigurtë për mbetjen e rrezikshme | Punime | T4 2006 | T2 2007 |
| Subvencioni i ndërtimit | Shërbime | T4 2006 | T2 2007 |
| 18 Forcimi i sistemit të monitorimit mjedisor | | | |
| Projektimi, planifikimi dhe zbatimi | Shërbime | T3 2005 | T1 2006 |
| Pajisjet | Pajisje | T2 2006 | T4 2006 |
| 19 Zhvillimi i qëndrueshëm dhe i integruar i korridorit Tiranë-Durrës | | | |
| Shih paragrafin 2.4 të fishës së projektit | Shërbime | T3 2005 | T1 2006 |

| 20 Mbështetje për sistemin e regjistrit të gjendjes civile | | | |
|---|---|---|---|
| Harwave dhe software IT | Pajisje | T1 2007 | T3 2007 |
| Asistencë teknike për menaxhimin e bazës së të dhënave të regjistrit të gjendjes civile, duke përfshirë procedurat/ instruksionet, trajnimin dhe zhvillimin strategjik, si dhe hedhjen e të dhënave | Shërbime/grant | T1 2006 | T3 2006 |

Kjo pajisje është në fakt një sistem për përgjimin dhe lokalizimin e telefonave celularë, i cili kërkon leje speciale dhe një ofrim të kontrolluar. Pra nevojitet shmangia nga rregullat e prokurimit në fuqi.

Nb: Grantet do të jepen normalisht nëpërmjet thirrjeve për propozime, të hapura ose të kufizuara[5], në varësi të tipit të detyrës. Grantet direkte do të jepen vetëm në rast të projekteve të menaxhuara bashkërisht siç parashikohet në rregulloren financiare dhe udhëzimin praktik.

5) Për organizatat ndërkombëtare ose institucionet e vendeve anëtare (p.sh. në rastin e marrëveshjeve të binjakëzimit).

**LIGJ**
**Nr. 9366, datë 31.3.2005**

**PËR GRADAT DHE KARRIERËN NË GARDËN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
**Objekti dhe qëllimi**

Ky ligj përcakton rendin e gradave, përparimin në gradë dhe në karrierë, përgjegjësitë, që rrjedhin nga karakteri i veçantë i detyrës dhe i shërbimit në Gardën e Republikës së Shqipërisë dhe ndërprerjen e karrierës së oficerit dhe nënoficerit të Gardës, në përputhje me ligjin nr.8869, datë 22.5.2003 "Për Gardën e Republikës së Shqipërisë".

Neni 2
**Përkufizime**

Në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. "Gradat" janë tituj dhe shenja dalluese në emërtesën e hierarkisë në Gardën e Republikës së Shqipërisë.
2. "Hierarkia në Gardë" është rendi i gradave dhe i funksioneve në Gardën e Republikës së Shqipërisë.

Për gradë dhe funksion organik të njëjtë qëndrojnë më lart në hierarki oficeri dhe nënoficeri i Gardës me vjetërsi më të madhe shërbimi.

3. "Rendi i gradave dhe i funksioneve" është shkallëzimi i gradave nga më e ulëta te më e larta, sipas lidhjeve dhe varësisë që kanë ndërmjet tyre.

4. "Karriera" është rendi i gradave të oficerit dhe nënoficerit të Gardës gjatë kohës që shërbejnë në strukturat e saj, sipas kualifikimit, aftësive drejtuese e profesionale dhe vjetërsisë në shërbim.

Neni 3

Oficeri dhe nënoficeri i Gardës, në varësi të gradës, klasifikohen në epror dhe vartës.

## KREU II
## GRADAT NË GARDËN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Neni 4

Në Gardën e Republikës së Shqipërisë gradat u jepen oficerëve dhe nënoficerëve të shërbimit aktiv.

Neni 5

Gradat për oficerët dhe nënoficerët klasifikohen në grada të ulëta, të mesme, të larta dhe madhore.

Neni 6

Gradat në Gardën e Republikës së Shqipërisë dhe barazvlefshmëria e tyre me gradat në Policinë e Shtetit janë si më poshtë:

A. Për nënoficerët:

| | Grada në Gardë | Grada korresponduese në Policinë e Shtetit |
|---|---|---|
| a) Grada të ulëta: | | |
| | Rreshter | Agjent; |
| | Kapter IV | Agjent. |
| b) Grada të mesme: | | |
| | Kapter III | Agjent i parë; |
| | Kapter II | Agjent i parë; |
| | Kapter I | Asistent. |
| c) Grada të larta: | | |
| | Kapter mjeshtër | Asistent; |
| | Kapter shtabi | Asistent i parë; |
| | Kapter | Asistent i parë. |
| ç) Grada madhore: | | |
| | Kryekapter | Kryeasistent. |

B. Për Për oficerët:

a) Grada të ulëta:

| | |
|---|---|
| Nëntoger | Nëninspektor; |
| Toger | Nëninspektor. |

b) Grada të mesme:

| | |
|---|---|
| Nënkapiten | Inspektor; |
| Kapiten | Kryeinspektor. |

c) Grada të larta:

| | |
|---|---|
| Major | Nënkomisar; |
| Nënkolonel | Komisar; |
| Kolonel | Kryekomisar. |

ç) Grada madhore:

| | |
|---|---|
| Gjeneral i Gardës | Drejtues. |

Neni 7

1. Koha e qëndrimit në gradë për oficerin dhe nënoficerin e Gardës është si më poshtë:
A. Për nënoficerët:

a) Grada të ulëta:

| | |
|---|---|
| Rreshter | 2 (dy) vjet; |
| Kapter IV | 3 (tre) vjet. |

b) Grada të mesme:

| | |
|---|---|
| Kapter III | 3 (tre) vjet; |
| Kapter II | 3 (tre) vjet; |
| Kapter I | 3 (tre) vjet. |

c) Grada të larta:

| | |
|---|---|
| Kapter mjeshtër | 4 (katër) vjet ose deri në daljen në pension për specialitete të veçanta; |
| Kapter shtabi | 5 (pesë) vjet; |
| Kapter | 5 (pesë) vjet. |

ç) Grada madhore:

| | |
|---|---|
| Kryekapter | 7 (shtatë) vjet. |

B. Për oficerët:

a) Grada të ulëta:

| | |
|---|---|
| Nëntoger | 2 (dy) vjet; |
| Toger | 3 (tre) vjet. |

b) Grada të mesme:

| | |
|---|---|
| Nënkapiten | 4 (katër) vjet; |
| Kapiten | 5 (pesë) vjet. |

c) Grada të larta:

| | |
|---|---|
| Major | 5 (pesë) vjet; |
| Nënkolonel | 5 (pesë) vjet; |
| Kolonel | 5 (pesë) vjet. |

2. Dhënia e gradës nga kolonel deri gjeneral i Gardës bëhet në bazë të aftësive drejtuese, profesionale, të arsimimit dhe kualifikimit.

3. Oficerët, që kanë fituar gradat e larta major deri nënkolonel dhe që shërbejnë në specialitete si inxhinier, mjek, ekonomist, jurist, financier, psikolog në xhenio, në armatim dhe në specialitete të tjera të ngjashme, të përcaktuara nga Ministri i Rendit Publik, në rast se nuk parashikohet gradë më e lartë, sipas funksionit organik që kryejnë, qëndrojnë në këtë gradë deri në kohën e daljes në pension të parakohshëm.

4. Nënoficerët, që kanë fituar gradën kapter mjeshtër dhe që punojnë në funksione të veçanta, të përcaktuara me urdhër të Ministrit të Rendit Publik, nuk mund të marrin gradë më të lartë për sa kohë qëndrojnë në atë detyrë.

Neni 8

Koha e qëndrimit në një gradë

| 1. Koha maksimale e qëndrimit në një gradë është si më poshtë: | Koha në shërbim |
|---|---|
| A. Titullimi i gradës për nënoficerët | |
| Rreshter | 6 (gjashtë) vjet; |
| Kapter IV | 8 (tetë) vjet; |
| Kapter III | 15 (pesëmbëdhjetë) vjet; |
| Kapter II | 18 (tetëmbëdhjetë) vjet; |
| Kapter I | 20 (njëzet) vjet; |
| Kapter mjeshtër | 27 (njëzet e shtatë) vjet; |
| Kapter shtabi | 29 (njëzet e nëntë) vjet; |
| Kapter | 32 (tridhjetë e dy) vjet; |
| Kryekapter | 35 (tridhjetë e pesë) vjet. |

| B. Titullimi i gradës për oficerët | Koha në shërbim |
|---|---|
| Nëntoger | 6 (gjashtë) vjet; |
| Toger | 8 (tetë) vjet; |
| Nënkapiten | 15 (pesëmbëdhjetë) vjet; |
| Kapiten | 18 (tetëmbëdhjetë) vjet; |
| Major | 23 (njëzet e tre) vjet; |
| Nënkolonel | 27 (njëzet e shtatë) vjet; |
| Kolonel | 30 (tridhjetë) vjet; |
| Gjeneral i Gardës | 35 (tridhjetë e pesë) vjet. |

2. Oficerit të Gardës, që ka 15 vjet shërbim dhe ka plotësuar afatin maksimal të qëndrimit në gradën kapiten, i lind e drejta e karrierës, në varësi të nevojave e të kualifikimit përkatës.

3. Oficeri dhe nënoficeri i Gardës, të cilët kanë plotësuar afatin maksimal të qëndrimit në një gradë dhe nuk kanë marrë gradën e radhës, dalin në rezervë.

4. Nga pika 1 e këtij neni përjashtohen oficerët e Gardës të përcaktuar në pikën 3 të nenit 7 të këtij ligji.

Neni 9

Vjetërsia në çdo gradë e oficerit dhe nënoficerit të Gardës, për efekt të marrjes së gradës së radhës, llogaritet si më poshtë:

a) kur plotëson kriteret, nga dita kur i lind e drejta për marrjen e kësaj grade;

b) kur nuk plotëson kriteret, nga dita e daljes së urdhrit për marrjen e gradës.

Neni 10

Ndërprerja e karrierës për shkak pezullimi për më shumë se 3 muaj nuk llogaritet si vjetërsi për efekt gradimi, përveç rastit kur pezullimi ose qëndrimi në dispozicion është bërë me urdhër ose vendim të paligjshëm apo të padrejtë, të përcaktuar si të tillë me vendim gjykate të formës së prerë. Në këtë rast koha e ndërprerjes së karrierës llogaritet si vjetërsi, për efekt gradimi.

KREU III
KARRIERA, KRITERET DHE MËNYRA E GRADIMIT NË GARDËN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Neni 11

Karriera dhe ecuria në gradë e oficerit dhe nënoficerit të Gardës janë në varësi të arsimimit dhe të kualifikimit për gradën dhe funksionin që kryejnë.

Neni 12

1. Për kualifikimin e oficerit dhe nënoficerit të Gardës krijohet Instituti i Gardës së Republikës.

2. Kurset e kualifikimit për oficerët, afatet dhe procedurat e zhvillimit të këtyre kurseve për çdo gradë, si dhe barazvlefshmëria e tyre me kurset e kualifikimit jashtë vendit përcaktohen me urdhër të Ministrit të Rendit Publik.

3. Kurset e kualifikimit për nënoficerët dhe procedurat e zhvillimit të këtyre kurseve për çdo gradë përcaktohen me urdhër të Komandantit të Gardës.

Neni 13

1. Gradat për nivelin nënoficer jepen nga Komandanti i Gardës, me propozimin e komisionit përkatës.

2. Kursanti, që përfundon kursin në Institutin e Gardës, titullohet nënoficer dhe i jepet grada rreshter. Të drejtën e propozimit për titullimin nënoficer, pas përfundimit të kursit, e ka Drejtori i Institutit të Gardës së Republikës së Shqipërisë.

Neni 14

1. Titullimi oficer aktiv dhe dhënia e gradës së parë të oficerit të Gardës bëhen me urdhër të Ministrit të Rendit Publik.

2. Studenti, që diplomohet në shkollat e larta ushtarake dhe të policisë, brenda dhe jashtë vendit, në universitetet civile, për specialitete të veçanta, pasi të ketë kryer kursin përkatës profesional, merr gradën nëntoger dhe titullohet oficer aktiv në Gardën e Republikës së Shqipërisë.

Studentit, që ka përfunduar kursin me rezultate të shkëlqyera, mund t'i jepet grada toger.

Neni 15

1. Oficerit dhe nënoficerit të Gardës u lind e drejta për gradimin e radhës kur:

a) kanë plotësuar afatin kohor të qëndrimit në një gradë, sipas nenit 7 të këtij ligji;

b) kanë kryer arsimin dhe kualifikimin e nevojshëm në shkollat përkatëse dhe në kurset e organizuara nga Instituti i Gardës, nga Policia e Shtetit apo kanë kryer kurse në universitete të tjera civile, brenda dhe jashtë vendit;

c) kanë rezultate dhe vlerësim vjetor pozitiv të punës.

2. Komisionet e gradave e të karrierës shqyrtojnë dhe vlerësojnë dhënien e çdo grade më të lartë për oficerin dhe nënoficerin e Gardës, si më poshtë:

a) për nënoficerin vetëm 1 herë;

b) për oficerin me gradën toger deri kolonel 2 herë;

c) për oficerin me gradën gjeneral i Gardës vetëm 1 herë.

Neni 16

Oficeri dhe nënoficeri i Gardës, për të fituar gradën e radhës, duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) nëntogeri fiton gradën toger pas plotësimit të afatit kohor të qëndrimit në gradën nëntoger;

b) togeri fiton gradën nënkapiten pas plotësimit të afatit kohor të qëndrimit në gradën toger, si dhe pasi të ketë kryer kursin përkatës në Institutin e Gardës ose kurse të tjera të barazvlefshme në akademitë e policisë apo në ato ushtarake, brenda ose jashtë vendit;

c) nënkapiteni fiton gradën kapiten pas plotësimit të afatit kohor të qëndrimit në gradën nënkapiten, si dhe pasi të ketë kryer kursin përkatës në Institutin e Gardës ose kurse të tjera të barazvlefshme në akademitë e policisë apo në ato ushtarake, brenda ose jashtë vendit;

ç) kapiteni fiton gradën major pas plotësimit të afatit kohor të qëndrimit në gradën kapiten, si dhe pasi të ketë kryer kursin përkatës në Institutin e Gardës ose kurse të tjera të barazvlefshme në akademitë e policisë apo në ato ushtarake, si dhe në shkolla të tjera të larta civile, për specialitete të veçanta, brenda ose jashtë vendit;

d) majori fiton gradën nënkolonel pas plotësimit të afatit kohor të qëndrimit në gradën major, si dhe pasi të ketë kryer kursin përkatës në Akademinë e Policisë "Arben Zylyftari" apo në Akademinë Ushtarake "Spiro Moisiu" ose kurse të tjera të barazvlefshme me to, brenda apo jashtë vendit;

dh) nënkoloneli fiton gradën kolonel pas plotësimit të afatit kohor sipas këtij ligji, si dhe pasi të ketë kryer kursin përkatës në Akademinë e Policisë "Arben Zylyftari" apo në Akademinë Ushtarake "Spiro Moisiu";

e) koloneli fiton gradën madhore pasi të ketë kryer kurs kualifikimi në Akademinë e Policisë "Arben Zylyftari", kursin e Kolegjit të Lartë të Mbrojtjes ose kurse në kolegje të larta jashtë vendit, të barazvlefshme me to, gjithashtu, duhet të ketë mbrojtur gjuhën angleze.

Neni 17

1. Oficerët, që kryejnë detyra në specialitetet e inxhinierit, të mjekut, ekonomistit, financierit, juristit, psikologut në xhenio, në armatim e në specialitete të tjera të ngjashme me to, të përcaktuara nga Ministri i Rendit Publik, e fitojnë gradën major në bazë të vjetërsisë në profesion dhe jo sipas kritereve të përcaktuara në nenin 16 të këtij ligji.

2. Oficerët e përmendur në pikën 1 të këtij neni, për të fituar grada më të larta, kur i parashikon funksioni organik, duhet të kryejnë kurset e kualifikimit, të parashikuara për çdo gradë, sipas nenit 16 të këtij ligji.

3. Kur oficerët e Gardës, të specialiteteve të përmendura në pikën 1 të këtij neni, plotësojnë kriteret dhe kërkojnë të përparojnë në gradë e karrierë, sipas përcaktimeve të pikës 2 të këtij neni, organet kompetente janë të detyruara t'u ofrojnë kurset e nevojshme të arsimimit dhe kualifikimit.

Neni 18

Gradimi i parakohshëm i oficerit dhe nënoficerit të Gardës në gradën e radhës mund të bëhet vetëm një herë gjatë karrierës së tyre, me propozimin e Komandantit të Gardës, në bazë të rezultateve të larta, të arritura gjatë kryerjes së misioneve me rrezikshmëri të lartë.

## KREU IV
## ORGANIZIMI I KONKURSEVE

### Neni 19

Për oficerët konkurrimet për fitimin e gradave zhvillohen çdo vit, me urdhër të Ministrit të Rendit Publik dhe për nënoficerët zhvillohen çdo vit, me urdhër të Komandantit të Gardës. Në këta urdhra përcaktohen edhe numri i vendeve të disponueshme për çdo gradë, afatet e paraqitjes dhe të pranimit të kërkesave, si dhe procedurat e zhvillimit të konkurrimit.

Shpallja e fituesve bëhet nga komisioni përkatës i gradave dhe i karrierës.

### Neni 20

1. Autoritetet kompetente për vlerësimin e përparimit të oficerëve e të nënoficerëve në gradë e karrierë, si dhe për kualifikimin e tyre janë komisionet e gradave dhe të karrierës.

Përcaktimi i komisioneve është si më poshtë:

A. Komisioni i gradave dhe i karrierës, për gradat e nivelit të lartë, të mesëm dhe të ulët, propozohet nga Komandanti i Gardës dhe miratohet nga Ministri i Rendit Publik.

Në këtë komision marrin pjesë:

a) gjenerali i Gardës;
b) dy kolonelë;
c) një nënkolonel;
ç) përfaqësuesi i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Rendit Publik.

B. Komisioni i gradave dhe i karrierës për nënoficerët, i cili miratohet nga Komandanti i Gardës, ka në përbërje:

a) një kolonel;
b) dy nënkolonelë;
c) një major;
ç) një kryekapter.

2. Komisionet e gradave e të karrierës i përfundojnë procedurat e punës deri në muajin qershor të çdo viti. Funksionimi i këtyre komisioneve përcaktohet me urdhër të Ministrit të Rendit Publik.

### Neni 21

1. Gradimet për oficerët e nivelit të ulët, të mesëm dhe të lartë në Gardën e Republikës bëhen me urdhër të Ministrit të Rendit Publik, në bazë të propozimit të Komandantit të Gardës, sipas rezultateve të shpallura nga komisionet e gradave dhe të karrierës së Gardës.

2. Grada madhore jepet me dekret të Presidentit të Republikës, me propozimin e Ministrit të Rendit Publik dhe pas miratimit të Kryeministrit.

### Neni 22

1. Për mosmarrëveshjet, që lindin gjatë procedurave të dhënies së gradës, oficeri dhe nënoficeri i Gardës kanë të drejtë të ankohen te Ministri i Rendit Publik brenda 10 ditëve. Ministri i Rendit Publik duhet të japë përgjigje brenda 30 ditëve.

2. Kur mosmarrëveshjet nuk zgjidhen sipas pikës 1 të këtij neni, oficerit dhe nënoficerit të Gardës u lind e drejta të ankohen në Gjykatën e Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit.

### Neni 23

Oficeri dhe nënoficeri i Gardës, që dalin në lirim për efekt moshe, paaftësie shëndetësore, si

dhe ata që dalin në rezervë, gëzojnë të drejtën e mbajtjes së uniformës dhe të gradës, që kishin në çastin e ndërprerjes së karrierës. Gjithashtu, ata lejohen ta mbajnë uniformën në raste festash zyrtare dhe gjatë ceremonive që organizon Garda e Republikës.

Neni 24

Oficeri dhe nënoficeri i Gardës në rezervë rikthehen në shërbimin aktiv, kur bëhen shtesa në personelin e Gardës. Në këtë rast ata mbajnë gradën, që kishin në çastin e daljes në rezervë.

Neni 25

Forma dhe elementet e gradave, të shenjave dalluese dhe të uniformës së oficerit dhe nënoficerit të Gardës së Republikës së Shqipërisë miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

## KREU V
## DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 26

1. Njësimi i gradave me funksionet organike dhe i pagës për gradë në Gardën e Republikës së Shqipërisë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Deri në momentin e miratimit të pagës për gradë, oficeri dhe nënoficeri i Gardës marrin shpërblimin mujor, sipas kritereve të përcaktuara për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Neni 27

1. Kur oficeri dhe nënoficeri i Gardës, me hyrjen në fuqi të këtij ligji, mbajnë një gradë më të ulët se ajo që u takon në bazë të vjetërsisë në shërbim, të arsimimit dhe kualifikimit, ata marrin gradën përkatëse, sipas kritereve të këtij ligji.
2. Përputhja e gradës me funksionin organik, sipas këtij ligji, bëhet për një periudhë deri në dy vjet nga çasti i hyrjes në fuqi të ligjit dhe jo më pak se koha e nevojshme për kryerjen e kursit të kualifikimit, për marrjen e gradës sipas funksionit.
3. Funksioni në asnjë rast nuk mund të jetë më i lartë se një shkallë për gradën korresponduese deri në çastin e përputhjes, sipas përcaktimit dhe afateve të caktuara në këtë ligj.

Neni 28

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 25 dhe 26 të këtij ligji.
2. Ngarkohet Ministri i Rendit Publik që, brenda dy muajve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 7 pikat 3 e 4, 12 pika 2, 14 pika 1, 17 pika 1, 19 dhe 20 pika 2 të këtij ligji.

Neni 29

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4540, datë 13.4.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu**

**Fletorja Zyrtare gjendet:**
Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;
- Qendrës së Publikimeve Zyrtare;
Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".
Tel: 042 555 63; 267 468

**Për çdo lloj informacioni shihni faqen e internetit në adresën**:
www.legjislacionishqiptar.gov.al

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

**BOTIMET:**

1. KUSHTETUTA (edhe anglisht)
2. KODI I PROCEDURËS CIVILE
3. KODI I PROCEDURËS PENALE
4. KODI PENAL
5. KODI I PUNËS
6. KODI I FAMILJES
7. KODI CIVIL
8. KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN
9. KODI ZGJEDHOR ( i azhurnuar)
10 KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE
11. DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

1. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT
2. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË
5. PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE

**DOLI NGA SHTYPI**

**TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004**
**TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004**

Doli nga shtypi më 28.4.2005

| Tirazhi: 4300 copë | Formati: 60x88/8 |
|---|---|

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2005

Çmimi: 150 lekë